
BAJRAM CURRI, TRIBUN I KOMBIT



- www.pashtriku.org -

(Bajram Curri me bashkëlufëtaret e tij)



~ GANI QARRI ~

Në historinë shekullore të të gjithë popujve të kësaj pjese të Evropës, ku bëjnë pjesë edhe shqiptarët, kombi ynë përherë u cilësuan si gjen i fortë e i qëndrueshëm dhe i dashuruar përjetshëm me lirinë dhe ruajtjen e tërësisë territoriale të atdheut të vet.

Ndihmesë të veçantë në këtë drejtim, padyshim dha Malësia. Nga vatra e saj lindën shumë trima e udhëheqës të shquar dhe figura të njohura atdhetare. Ata, kudo vazhduan jetën dhe veprimtarinë e tyre, u kthyen në lavdi të këtij populli, me të cilët edhe sot krenohet çdo shqiptar.

Ishte koha kur Lëvizja Kombëtare për çlirim, kishte marrë hov dhe lufta kundër-osmane ndizej flakë gjithandej Malësisë dhe Vilajetit të Kosovës. Ndaj, pas udhëheqjes së një kryengritjeje ato mote nga Binak Alia dhe i ati, i Plakut të Maleve, Shaqir Curri, Qeveria Turke si masë ndëshkimi për mos dorëzimin e Shaqir Currit, i kishte arrestuar të shoqen e Shaqirit, nënën shtatzënë me Bajram Currin e paardhur ende në jetë, bashkë me disa pjesëtarë tjerë të familjes dhe nisur për internim në Anadoll.



Bajram Curri (1862-1925)

Pikërisht gjatë atij rrugëtimi, derisa ata të rrethuar nga ushtarë e xhandar të armatosur turq ecnin përgjatë rrugës Gjakovë-Prizren, me të arritur në afërsi të fshatit Krushë e Madhe, në drejtim të Prizrenit, në vitin 1862, mu në kafazin e qerres me të cilën familja e tij e burgosur udhëtonte nën rrethim policor, për në internim, do të lindej Bajram Curri.

Nga aty, fati i keq, këtij burri nuk do t'i ndahej asnjëherë, gjatë gjithë jetës, duke filluar që nga lindja e tij në një udhëtim syrgjynosje, vrasja e babait kur ai ishte vetëm 16 vjeçar, nga ish bashkëluftëtarët e vet më 6 shtator të vitit 1878, në kullat e Abdullah pashë Drenit në Gjakovë i cili kishte strehuar Magjar Pashën dhe ftuar edhe Hysni Currin si mik shtëpie për mbrojtje nga sulmet e luftëtarëve të Lidhjes, e deri te përfundimi tragjik i vet jetës së Bajram Currit, i cili do të vritej pabesisht nga shërbëtorët e Serbisë, me në krye Cano beg Kryeziun e Gjakovës, më 29 mars të vitit 1925, në Dragobinë kreshnike të Malësisë.

Bajram Curri gjatë gjithë veprimtarisë së tij atdhetare do të dallohej si organizator, politikan, udhëheqës dhe ushtarak i shquar, i cili jo vetëm se ishte idealist i flakët i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por ai do të shkëlqente edhe si prijës dhe organizator i shquar i lëvizjes kundërosmane në të gjitha trojet shqiptare, kudo që luftohej për liri, që nga Vilajeti i Kosovës, Hasi, Malësia, Shkupi, Manastiri, Plava e Gucia, Shqipëria e Jugut si në Vlorë, e Mesme, Durrësi, Lezha,

Kopliku e gjetiu, e deri te përfaqësimi i shqiptarëve në Parlament dhe Qeverinë shqiptare në Tiranë.

Fatkeqësi të shpeshta do ta përcillnin Plakun e Maleve, pareshtur, madje njëra nga to, do ti vinte në një mënyrë tejet të pa pritur, të çuditshme dhe gati tërësisht të pabesueshme, për shqiptarët.

Në shtatorin e vitit 1878, vet përndjekësi dhe internuesi i familjes së Bajram Currit, Mehmet Ali pashë Maxhari, pas vendimeve të Kongresit të Berlinit i cili i falte një numër teritosh shqiptare edhe shtetit malazez, së pari kishte ndaluar në Prizren, për të bindur kryetarin e Lidhjes Ymer Prizrenin, për pranimin e pazareve të Berlinit, por pas dështimit të bisedimeve me Ymer Prizrenin, nga qyteti i Lidhjes, Mareshali osman, do të vinte në Gjakovë, tanimë- jo për të arrestuar Shaqir Currin, por për t'ia dorëzuar pa dëshirën e shqiptarëve, Plavën dhe Gucinë, Malit të Zi.

I ndjekur këmba këmbës, nga luftëtarët e Lidhjes së Prizrenit, mareshali otoman, do të strehohej në kullat e Abdullah pashë Drenit në Gjakovë.

Pas rrethimit të atyre kullave, nga kryengritësit shqiptar të cilët kërkonin kokën e Maxhar pashës, Abdullah pashë Dreni, si mik shtëpie që e kishte, do ta ftonte në ndihmë edhe Shaqir Currin.

Ndaj, me gjithë përpjekjet dy-tre ditore, në pamundësi të arritjes së një marrëveshje për kthimin e mareshalit otoman nga kishte ardhur, do të fillonin luftimet, me ç' rast përveç Maxhar pashës, e Abdullah Drenit, në përpjekje me luftëtarët e Lidhjes, do të vritej edhe Shaqir Curri, babai i Plakut të Maleve.

Por megjithëse atëkohë, heroi ynë ishte i ri dhe vetëm 16 vjeçar, ai do ta vlerësonte ngjarjen drejtë që atëherë, dhe gjithmonë do të mbante qëndrim të dinjitetshëm e të arsyeshëm atdhetar.

Madje, Heroi ynë, deri në fund të jetës së vet, nuk do të pushonte së luftuari pushtuesit osman, as ndalonte përpjekjet për çlirimin e vendit të tij, duke sakrifikuar gjithçka për ruajtjen e trojeve shqiptare dhe bashkimin e tyre në një shtet të përbashkët kombëtar.

Përkrahës i Haxhi Zekës dhe mbështetës i arsimit shqip

Me rastin e formimit të Lidhjes së Pejës nga patrioti i famshëm Haxhi Zeka, në vitin 1899, e cila konsiderohej si vijuese besnike e përpjekjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Bajram Curri do të dëshmohej si përkrahësi më besnik i Haxhi Zekës dhe Lidhjes së sapo formuar, të njohur si “Besa-Besë”!

Sipas Dr. Jusuf Bajraktarit, njohës i mirë i jetës dhe veprimtaris së heroit, nga viti 1906, Bajram Curri do të emërohej komandant i forcave të xhandarmërisë në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës në Shkup, të cilin sipas historianit tjetër, dr. Hakif Bajramit ,për kohë të shkurtër , ai do ta kthente në qendrën kryesore të organizimit patriotik gjithëshqiptar.

Madje nga pozita që kishte, Bajram Curri, atëbotë do të ndihmonte shumë edhe në sigurinë dhe mbarëvajtjen e Kongresit të Alfabetit, më 1908, në Manastir.

Ky Hero, mbështeti pa kursim dhe me tërë qenien e tij njerëzore, shkollimin shqip dhe arsimimin e të rinjve nga të gjitha trojet tona etnike, formimin e klubeve shqiptare, i cili një kohë edhe vet ishte nënkryetar i klubit “Bashkimi” të Shkupit, si dhe u tregua mbrojtës i vendosur i alfabetit kombëtar të Manastirit dhe ndihmues i palodhur i hapjes së shkollave në gjuhën shqipe gjithandej trojeve shqiptare.

Si luftëtar i shquar dhe arsimdashës i madh që ishte, me përpjekjet e pareshtura të tij, në dekadën e dytë të shekullit XX, u hapën shumë shkolla në gjuhën shqipe edhe në Kosovë, si në Gjakovë (më 1915), Malësinë e Gjakovës, në Has, Lumë etj. Ai i dërgoi dhjetëra shqiptarë nga Kosova për të vazhduar mësimet në Krumë, Shkup, Tiranë, Elbasan e më vonë deri në kryeqytetin Austriak në Vjenë, ku përveç tjerëve pati dërguar edhe letrarë dhe kritikun e mirënjohur kombëtar, Kristë Maloku nga Prizreni. Shkollimi i rinisë së vendit asokohe, ishte edhe pjesë e programit të luftës kombëtare kundër tendencave asimiluese ndaj popullit shqiptar nga perandoria osmane si dhe qeveritë shoviniste të shteteve fqinje, të cilat përpiqeshin po ashtu pareshtur për asimilimin me çdo kusht, të pjesëtarëve të kombit tonë, pushtimin e trojeve të Shqipërisë etnike, si dhe për shpërnguljen dhe zhdukjen e tërësishme të shqiptarëve.

Zbatues i vendimeve të Kuvendit të Junikut

Si pjesëmarrës i luftës së vitit 1911 në Malësinë e Mbishkodrës, ai do të dallohej me qëndresën e fortë që u bëri ushtrisë osmane që atje, kurse pas vendimeve të Kuvendit të Junikut, Bajram Curri do të shquhej si njëri ndër prijësit, organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të kryengritjes së përgjithshme kombëtare.

Ndaj, edhe pas Kuvendit të Junikut, kur do të merrej vendim për kryengritje të përgjithshme, këtij burri të madh të kombit, do ti binte barra kryesore, për udhëheqjen e kryengritjes, i cili bashkë me Zeqir

Halilin pas përgatitjeve të shpejta, do të niste ndër të parët betejat e mëdha çlirimtare, që nga Qafa e Prushit në Has e deri me çlirimin e Shkupit si kryeqytet i atëhershëm Vilajetit të Kosovës.

Kryengritja e vitit 1912, ishte kryengritja e periudhës së fundit të Rilindjes sonë kombëtare, e cila ndryshe njihet si Kryengritje e Përgjithshme e Shqiptarëve, dhe si e tillë, ajo ishte kryengritja më e mirë-organizuar dhe ndër kryengritjet më të mëdha që njihete populli ynë, qysh nga koha e lavdishme e Skënderbeut.

Bajram Currit, ashtu si edhe shumë patriotëve të tjerë në kohën e tij, atbotë i duhej të luftonte në dy fronte, si kundër ekspeditave ndëshkimore turke, ashtu edhe kundër elementeve antikombëtare, që bënë punë të përbashkët me pushtuesit kundër çlirimit të vendit dhe lirisë së mirëpritur të shqiptarëve.

Lufta e Qafës së Prushit

Pas mbajtjes së Kuvendit të Junikut, në shenjë solidarizimi me vendimet e tij, udhëheqësit e njohur shqiptarë të luftërave kombëtare, si Isa Buletini, Bajram Curri, Zeqir Halili, Idriz Seferi, Mehmet Deralla etj., kishin filluar përgatitjet para intensive për nisjen e furishme të luftimeve, gjithandej trojeve etnike

Ndaj, sipas traditës së kohës, Bajram Currit dhe Zeqir Halili, para nisjes së betejave kundër forcave pushtuese osmane, së pari do të ftonin në selinë e tyre, vendosur në njërin nga familjet më të mëdha në Has, në Kullën e Salih Qarrit, prijësit e Gashit dhe të Bytyçit, me të cilët do të besatoheshin për luftë të përbashkët kundër trupave pushtuese osmane, si në të kaluarën e afërt të viteve 1910-1911, kur të njësuar luftonin trimërisht kundër forcave të Turgut Pashës, ngjarje historike të cilës edhe këngëtari popullor do ti këndonte me respekt:

U mblodh Krasniqja, janë ra tu Qarri

Ranë tu Qarri e janë besatue

Krejt bajraqet me u bashkue

Lufta në Qafë të Prushit

Represionet e vazhdueshme turke dhe mohimi kategorik i të drejtave kombëtare e njerëzore ndaj shqiptarëve, quan në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912. Pas besatimit të parisë së fiseve, kryengritësve të Hasit dhe të Krasniqes do t'u bashkoheshin edhe kryengritësit e Gashit dhe të Bytyçit, të cilët nën udhëheqjen e Bajram Currit dhe Zeqir Halilit më 9 korrik të vitit 1912, do të sulmonin

garnizonin turk në Qafë të Prushit, të përbërë nga katër batalione ushtarësh, duke i mundur në fushëbetejë dhe shkaktuar atyre një disfatë të plotë.

Në luftimet e zhvilluara me garnizonin turk në Qafë të Prushit, mbetën shumë të vrarë e të plagosur si dhe ushtarë e oficerë osman të zënë robër, në mesin e të cilëve edhe vet udhëheqësi i garnizonit, Bedri beu të cilin, për bëmat e tij ,gjatë ekspeditave të njohura xhonturke, nga vitit 1909,1910, 1911, që njihen si vitet më të rënda për shqiptarët, por dhe varjen e Shaban Binakut dhe Abdullah Hoxhës në Gjakovë, do ta ekzekutonte atë dhe disa oficer të tjerë, kurse ushtarët e thjeshtë pas çarmatosjes, Bajram Curri do t'i lironte të shkonin në Gjakovë, ku do ta demoralizonin edhe garnizonin turk atje, si dhe nxitnin dezertimin e ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë, shumica prej të cilëve do t'u bashkoheshin forcave të kryengritjes së përgjithshme kombëtare.

Një fitore e tillë do të përshëndetej me entuziazëm edhe nga udhëheqësi kryesor i kryengritjes së përgjithshme, Hasan Prishtina, ngase në këtë betejë të lavdishme përveç ngritjes së moralit luftarak të kryengritësve, do të kapeshin edhe shumë municione dhe armatime, që nga pushkët deri te mitralozat dhe topat luftarakë, me të cilat do të armatoseshin luftëtarët shqiptarë, për zhvillimin e betejave të reja, që përhapeshin me të shpejt në Kosovë dhe gjithandej trojeve shqiptare.

Edhe në këtë luftë si në të gjitha kryengritjet kombëtare, Bajram Curri do të shkëlqente për aftësitë e tij organizative, ushtarake dhe udhëheqëse, betejat e të cilit që nga Qafa e Prushit, do të vazhdonin në Gjakovë, Fushë-Kosovë, Prishtinë e deri te çlirimi i Shkupit dhe gjithë vilajetit të Kosovës.

Çlirimi i Shkupit

Përparimi i forcave kryengritëse, nuk kishte të ndalur. Ndaj, nga muaji Maj deri në fillimgushtin e vitit 1912, kryengritësit kombëtar do të çlironin shumicën e vendbanimeve më të mëdha të Kosovës dhe qytetet kryesore shqiptare. Nga Qafa e Prushit në Has, ata vazhduan me çlirimin e Gjakovës, Fushë Kosovës e Prishtinës, ku Bajram Curri në krye të 12 mijë kryengritësve, do të hynte triumfalisht asokohe.

Ndaj, më 9 gusht të vitit 1912,udhëheqësit e luftës së përgjithshme me në krye Hasan Prishtinën, do t'i paraqisnin Memorandumin e fundit qeverisë xhonturke, me një ultimatum prej 48 orësh, për plotësimin e kërkesave të shqiptarëve, para se ata ta çlironin edhe Shkupin.

Por pasi që kërkesat e kryengritësve do të injoroheshin dhe ata nuk do të merrnin asnjë përgjigje nga qeveria osmane, me vendimin e Hasan Prishtinës, plani për çlirimin e Shkupit, do t'i besohej Bajram Currit, i cili si ish udhëheqës (nga viti 1906), i xhandarmërisë në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, ai njihte më së miri dhe deri në detaje çdo pjesë të tij, ndaj nga Prishtina me 6000 luftëtarë, heroji tanimë ishte vendosur në Ferizaj, dhe priste sinjalin nga Hasan Prishtina, për çlirimin përfundimtar të Shkupit, kryeqendrës së atëhershëm të Kosovës.

Me të përfunduar përgatitjet për fillimin e sulmit të përgjithshëm, për arkitekt të pararojës dhe ngritjes së Flamurit Kombëtar mbi Shkupin e lirë, Bajram Curri zgjodhi Bajram Daklanin, udhëheqësi kryesor i kryengritësve nga Krasniqja dhe Reka, i cili siç e thoshte edhe kënga; *“ai jo vetëm se e kishte adet, nga një Çaushe me vra për vjet”*, por ishte edhe njëri nga udhëheqësit më të besueshëm, në radhët e prijësve kombëtarë që asokohe kishin kap armët për çlirimin përfundimtar të shqiptarëve.

Ngritja e Flamurit mbi Shkup

Para marshimit të planifikuar, Plaku i Maleve do ta pajiste Bajram Daklanin me një Flamur të madh Shqiptar dhe vinte në krye të 200 luftëtarëve pararojë, me detyrën që të hynte i pari në kryeqytet dhe vendoste Flamurin Kombëtar të fitores mbi qendër të Shkupit.

Siç shkruante edhe gazeta “Shkupi” e datës 19 gusht të vitit 1912, pikërisht më 12 gusht të atij viti, nga Ferizaj, Bajram Daklani në krye të 200 bashkëluftëtarëve pararojë, do të futej triumfalisht në kryeqytet dhe pas 500 vjetësh sundimi turk, ai i pari do ta ngrinte lart dhe me krenari, Flamurin Kombëtar të fitores në Shkup.

Në ish kryeqytetin e çliruar të Kosovës, ditëve në vijim, njëri pas tjetrit, do të mblidheshin të gjithë prijësit kryesor të kryengritjes me mese 30 mijë luftëtarë, me ç’rast udhëheqja shqiptare e luftës, si në Shkup, ashtu edhe në qytetet e tjera të çliruara do t'i shkarkonte të gjithë qeveritarët e administratorët turq, si dhe përkrahësit e mbetur fanatik të Perandorisë së shuar osmane, pushtueses së kamotshme të shqiptarëve.

Lotët e gëzimit

Pas aq vitesh lufte e përpjekje, për herë të parë Bajram Currit do ti rridhnin lot. Ai kishte qëndruar për disa kohë si funksionar i lartë në kryeqytet, por gjithmonë nën hijen e flamujve të huaj, kurse tani, për

herë të parë në jetën e tij, shihte Shkupin e stolisur me Flamur Kombëtar. Ndaj si heroi vet, ashtu edhe të gjithë kryengritësit shqiptar, këtë akt kaq sublim, do ta përjetonin me lot gëzimi dhe kujtonin me admirim deri në vdekje.

Shkupi ,si qyteti me numrin më të madh të shqiptarëve dhe kryeqendër e Vilajetit të Kosovës, nuk ishte hera e parë që çlirohej nga shqiptarët, ai ishte çliruar edhe nga Dervish Cara qysh në fillim marsin e vitit 1844, kurse më 4 janar të vitit 1881, nga forcat e Lidhjes së Prizrenit, ndërsa në Javën e dytë të gushtit, apo më 12 gusht të vitit 1912, për herë të tretë, u çlirua sërish edhe nga Bajram Curri me bashkëluftëtar.

Me të arritur atje me rreth 6000 luftëtarët e tij, Bajram Curri, pas marrjes së postë-telekomit, së pari do ti lironte edhe rreth 1000 të burgosurit shqiptarë, të mbyllur padrejtësisht nga ish organet pushtuese xhonturke, ndërsa çlirimi i Shkupit - kryeqytetit të vilajetit të Kosovës - si ngjarje historike për kombin dhe popullin shqiptar , do ta rrëzonte qeverinë e pushtetit perandorak turk dhe trazonte të gjithë Perandorinë osmane.

Dorëheqja e kryeministrit xhonturk

Pra, në krejt këto përpjekje sublime të popullit tonë, Bajram Curri ishte njëri ndër prijësit kryesor dhe më të suksesshëm të luftës së filluar, që nga 5 maji i vitit 1912, e cila pas mbajtjes së Kuvendit të Junikut, u shndërrua në Kryengritje të Përgjithshme Kombëtare, dhe më 18 gusht të vitit 1912, nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit, Idriz Seferit, Zeqir Halilit dhe Mehmet Derallës, do të arrihej çlirimi i tërë Vilajetit të Kosovës, gjë që edhe do të çonte në dorëheqjen e Said Pashës, kryeministrit të kabinetit të atëhershëm xhonturk.

Kjo Kryengritja Historike, përveç figurave të Hasan Prishtinës dhe Isa Buletinit, lidhet tejet ngushtë edhe me emrin e nderuar të Bajram Currit, e cila pas çlirimit të tokave shqiptare, do të çonte në Shpalljen përfundimtare të Pavarësisë së Shqipërisë Etnike, më 28 Nëntor të vitit 1912.

Planifikimi i shpalljes së Pavarësisë kombëtare në Shkup!

Pas çlirimit të tij, kryeqyteti i Vilajetit të Kosovës, tanimë ishte kthyer në kryeqendër të të gjithë gjeografisë shqiptare, ndaj me të drejtë, nga kryengritësit, përveç ngritjes së Flamurit aty, që me kohë ishte planifikuar edhe shpallja e Pavarësisë Kombëtare në Shkupin e çliruar.

Por, megjithatë, përkundër të gjitha masave të ndërmarra, përgatitjeve intensive dhe planit të detajuar për shpalljen e Pavarësisë Kombëtare në Shkup, fatkeqësisht, ky akt madhor nuk do të ndodhte atje, pikësëpari, shkak i mos akordimit të vet udhëheqësve shqiptar, të cilët mu në momentin vendimtar e injoruan Hasan Prishtinën, fakt që do të përdorej me shpejtësi nga faktori ndërkombëtar, të cilët shfrytëzuan me mjeshtri mos-koordinimin e shqiptarëve.

Ndaj, sado që arritjet e tilla sublime do t'i gëzonin shumë të gjithë shqiptarët pa përjashtim, të cilët pas 500 vjetësh robërie, për herë të parë e ndienin veten të lirë dhe të pavarur, fatkeqësisht gëzimi i tyre do të shkurtohej ende pa u shijuar mirë, pasi që shtetet hegjemoniste fqinje, me mbështetjen e Rusisë dhe të Francës, të cilat favorizonin copëtimin e tokave shqiptare, tanimë kishin krijuar të ashtuquajturën aleancë ballkanike dhe përgatitnin nisjen e aksioneve ushtarake për pushtimin me forcë të trojeve tona etnike.

Ultimatumi i Fuqive të Mëdha

Sukseseve të luftës së kryengritësve shqiptar, ashtu siç nuk do t'u gëzohej Perandoria turke, nuk do t'u gëzoheshin as Rusia dhe vendet hegjemoniste fqinje përreth trojeve tona, ndaj, sipas dr. Hakif Bajramit, vetëm tri ditë pas ngritjes së Flamurit Kombëtar në Shkup, më 15 gusht të vitit 1912, nga Beogradi në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, do të arrinin tre diplomatë të lartë evropianë, një rus, një anglez dhe një austriak me një ultimatum në dorë.

Ata, kërkonin ndalimin e menjëhershëm të kryengritjes kombëtare, çarmatosja e detyrueshme të shqiptarëve dhe demobilizimin e të gjithë kryengritësve popullorë, me arsyetimin se nuk do të pranoheshin rezultatet e luftës së tyre çlirimtare, as ndryshimi i kufijve të Perandorisë otomane me forcën e armëve.

Të shokuar nga qëndrimi i Fuqive të mëdha, Hasan Prishtina me gjeneralët e tij, Bajram Currin, Isa Buletinin, Idriz Seferin, Bajram Daklanin etj., më kot do të ngulnin këmbë në të drejtën e Popullit Shqiptar për çlirimin e vendit vet dhe formimin e shtetit të tyre kombëtar, për ç'arsye, sipas historianit Dr. Hakif Bajrami, ata në Shkup dhe rrethinë për 4 ditë me radhë, edhe do të thirrin gjendjen e jashtëzakonshme.

Nën diktatin e gjendjes së krijuar dhe presionin e Fuqive të Mëdha, më 18 gusht të vitit 1912, do të arrinte edhe përgjigja e qeverisë

perandorake turke, sipas të cilës, pranoheshin 12, por jo të 14 pikat e parashtruara në emër të popullit shqiptar, nga Hasan Prishtina.

Ky vendim i vuri në vështirësi të mëdha kryengritësit dhe udhëheqësit e tyre, ngase pikërisht-dy pikat e refuzuara nga xhonturqit, ishin kërkesat kryesore të kryengritësve, të cilat kishin të bënin me njohjen e kombit shqiptar dhe pranimin e shtetit të tij, por fatkeqësisht edhe në momentet e fundit të Perandorisë otomane, kur ajo po jepte shpirt, turqit nuk donin ta njihnin popullin tonë as pranonin shtetin autonom shqiptar, qoftë edhe në kuadër të Perandorisë së tyre, e cila tanimë ishte në grahmat e fundit të jetës së saj, në këto troje.

Madje, megjithëse mu refuzimi i atyre dy pikave vinte në pikëpyetje edhe ekzistencën e tërësishme të shqiptarëve në Ballkan, kryengritja e përgjithshme, me pikënisje betejën e Qafës së Prushit, nga 9 korriku i atij viti, përkundër të gjitha pengesave dhe vështirësive, përfundimisht do të qonte në çlirimin e tërësishëm të të gjitha trojeve të Atdheut nga Perandoria otomane, dhe shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë Etnike, më 28 Nëntor 1912, në Vlorë.

Pushtimet Ballkanike

Mjerisht, jo vetëm se përgjigja gjysmake turke do të mjaftonte për Fuqitë e Mëdha, të cilat që nga mesi i shtatorit të vitit 1912, do të fillonin tregtinë me trojet shqiptare, por edhe ngrehina e sëmurë dhe e dalë mode e Bosforit, përveç pengesave tjera, vazhdonte me kokëfortësi edhe më tej të deklaronte se si tokat shqiptare i takonin Perandorisë së saj.

Kështu që, pretendimi turk, u kthye edhe në një fatkeqësi të madhe për shqiptarët dhe pretekst i mirëpritur nga Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, të cilat, në emër të “çlirimit” të popujve ortodoksë nga shteti “osman”, në tetor të vitit 1912, të mbështetura edhe nga Rusia, do t’i shpallnin luftë Perandorisë turke, për të pushtuar me forcën e armëve, trojet etnike shqiptare.

Mbrojtës i vendosur i tokave të atdheut

Tradhtia e Fuqive të Mëdha ndaj popullit dhe trojeve tona, të cilat pas çarmatosjes së shqiptarëve, miratuan në heshtje ekspansionin e shteteve hegjemoniste fqinje, detyruan Bajram Currin, Hasan Prishtinën dhe udhëheqës të tjerë të shquar kombëtar, që në ato rrethana të rënda, kudo në trojet shqiptare, të formonin komitetet për shpëtim.

Ndaj, nga mesi i shtatorit të vitit 1912, Bajram Curri do të detyrohej që nga Shkupi të kalonte në Gjakovë, për tu vendosur në frontin verior, ku forcat serbo-malazeze ishin përqendruar në vijën, Plavë-Guci-Rugovë e Pejës, të cilat ai do ti mbronte me të gjitha forcat dhe mundësitë.

Madje, në fund të tetorit të atij viti, në vazhden e përpjekjeve të tij për shpëtimin e Çenjëse Shqiptare, kur Fuqitë e Mëdha qonin kombin shqiptar në rrezik të zhbërjes, për mbrojtjen e trevave të rrezikuara në frontin verior, Bajram Curri do t'i angazhonte në luftimet mbrojtëse edhe shqiptarët e liruar nga burgjet xhonturke në Shkup. (*Dr. Hakif Bajrami "Pse Bajram Curri nuk ishte në Vlorë më 28 Nëntor të vitit 1912"*)

Kushtrimi i kryengritjes së përgjithshme për liri dhe bashkim kombëtar, do të përsëritej disa herë në ato kohë dhe situata të vështira për fatin e mjerë të Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo. Madje, edhe pas shpërthimit të Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, Bajram Curri do të dëshmohej si njëri ndër mbrojtësit më të flakët dhe udhëheqësi më emblematik për ruajtjen e Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe qëndresëtari më i vendosur kundër copëtimit të trojeve shqiptare. Ndaj, siç do të luftonte në krye të forcave mbrojtëse popullore në luftërat e zhvilluara kundër ushtrive pushtuese serbo-malazeze, në Plavë, Guci, Gash e Krasniqe, heroi ynë, njëjtë do të vepronte në Kosovë e Shqipëri dhe kudo paraqitej nevoja në frontin shqiptar, për mbrojtjen e tokave të rrezikuara kombëtare.

Megjithatë, sipas shënimeve të Skënder Drinit në librin biografik kushtuar Bajram Currit "Fuqitë Evropiane, jo vetëm se çarmatosën luftëtarët tanë kombëtarë, por me rifillimin e organizimit të tyre për mbrojtjen e tokave të veta nga serbo-malazet, nisën edhe t'i akuzonin shqiptarët, kinse ata donin të mbronin Perandorinë turke." (*Skënder Drini, Bajram Curri, fq. 167, Tiranë, 1983.*)

Pengimi i shkuarjes së Bajram Currit në Vlorë

Para një gjendje aq të rëndë, të krijuar asokohe nga ndërhyrjet e ushtrive okupuese të vendeve hegjemoniste fqinje, lufta më e ashpër në veri, zhvillohej në frontin e Pejës, ku patriotët shqiptar ishin fortifikuar në istikame për mbrojtjen e Plavës, luftime të cilat i udhëhiqte Bajram Curri.

Madje, mu në vijat e atij fronti, heroi do të mësonte edhe për mbajtjen e kuvendit kombëtar, që do të shpallte Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë.

Ndaj, në masën që lejonin rrethanat e luftës, ai mori disa nga trimat me vete dhe u nis për në Vlorë, dhe sipas dr. Hakif Bajramit, deri **në Mat**, heroin do ta përcillnin kreshnikët e fiseve nga ai kalonte, por me të arritur në vendin e quajtur Urakë, Bajram Curri me bashkudhëtarët e tij, nuk gjetën aty asnjë mjet lundrimi për ta kaluar lumin.

Madje përkundër të gjitha përpjekjeve, gjendja ishte përgatitur në atë mënyrë që Bajram Currit, gjithsesi t'i pamundësohej arritja në Vlorë, ndaj i dëshpëruar, ai u detyrua të kthehej nga kishte ardhur, duke u ngjitur sërish në istikamet e frontit të luftës, ku e priste përballja me ushtritë serbo-malazeze.

Për këtë shërbim në prani të Nikollë Ivanajt, (përkthyes) Nikolla Pashiqi më 1913 do t' i falënderohet "përzemërsisht" prijësit matjanë (mendohet në A. Zogun). (*dr. Hakif Bajrami "Pse Bajram Curri nuk ishte në Vlorë më 28 Nëntor të vitit 1912".*)

Konferenca e Londrës dhe vulosja e coptimit të trojeve shqiptareMjerisht, ende pa kaluar as një vit i plotë nga shpallja e Shqipërisë "Shtet i Lirë dhe Sovranë", sipas dëshirës së Fuqive të Mëdha, Konferenca e Ambasadorëve të tyre në Londër, e cila kishte filluar punimet që në dhjetorin e vitit 1912, më 23 mars të vitit 1913, së pari do të shpaloste planin për ndarjen e trojeve shqiptare ndërsa pas diskutimeve të gjata rreth 7-8, mujore, më 29 korrik të vitit 1913, përfundimisht solli edhe vendimin tragjik, për vulosjen e ndarjes së Shqipërisë dhe copëtimin përfundimtar të trojeve tona etnike, duke ua kaluar padrejtësisht, pjesën më të madhe të tyre, shteteve hegjemoniste fqinje.

Por heronjtë e kombit dhe prijësit e kryengritjes së përgjithshme kombëtare, Bajram Curri e Hasan Prishtina dy burra, ndër më të mëdhenjtë që pati kombi dhe shqiptarët në përgjithësi, megjithëse jetuan dhe vepruan në kohë e gjendje të jashtëzakonshme dhe u ballafaquan me shumë sfida e vështirësi nga të cilat patën *suksese por, përjetuan edhe dhembje e vuajtje të pa-përshkruara*, ata nuk u pajtuan kurrë me copëtimin e trojeve shqiptare, pushtimin e tyre nga shtetet fqinje, as mbetjen e Kosovës nën Serbi.

Ndaj edhe pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe vendimeve tragjike të saj nga 29 korriku i vitit 1913, ata ndihmuan pa

kursim dhe mbështetën me të gjitha mundësitë njerëzore, financiare e organizative, çdo nismë, aksion dhe kryengritje të armatosur e cila zhvillohej për liri dhe bashkim të trojeve kombëtare kudo.

Shpërthimi i Kryengritjes në Malësi

Nga fundi i shtatorit të vitit 1913, i njoftuar për gjendjen e rëndë të malësorëve të cilët nga represioni serb, ishin detyruar ti linin shtëpitë dhe iknin nëpër male, Bajram Curri do të kthehej vet nga Shkodra, dhe organizonte kryengritjen e armatosur në Malësi, kundër pushtuesve serbo-malazez që terrorizonin shqiptarët në vatrat e veta.

Pas shpërthimit të luftimeve, betejat më të përgjakshme u zhvilluan në Qafë të Morinës, për tu zgjeruar, pa kaluar shumë kohë, edhe në pjesët e tjera të Malësisë.

Sipas citimit të disa shënimeve me rëndësi në “www.pashtriku.org”, nga qëndresa e fortë e luftëtarëve të Bajram Currit, komanda supreme serbe do të detyrohej që të rriste numrin e forcave të saj në 12 mijë trupa, të cilat drejtoheshin nga gjeneralët më famëkeq serbo-malazez, si Sava Lllazaroviç, oficer i lartë (gjeneral)serb i cili kishte bërë kërdi me vrasjen masive të shqiptarëve, ndaj ndryshe në popull njihej edhe si Savë-Batarja, si dhe Radomir Veshoviç, gjenerali më famëkeq malazez, i cili në një periudhë të shkurtër dhe vetëm rreth 6 mujore ,do të vriste me tradhti jo më pak se tri figurat tona më të shquara kombëtare dhe më të njohura të kohës, si Çerçiz Topullin në paraditen e 15 korrikut 1915, në shtoj të Shkodrës, i cili kishte shkuar të mbronte Shkodrën, dhe Mehmet Shpendin pasditen e së njëjtës datë, pra po-ashtu më 15 korrik të vitit 1915, në vendin e quajtur Qeresh-Plan afër Plavës, të cilin gjenerali Veshoviç vet e kishte ftuar ,gjoja për bisedime, kurse Isa Buletinin,pas pak më tepër se 6 muajsh, pikërisht më 23 janar 1916, derisa ai me të bijt dhe nipat,pa të keq, kalonin mbi urën(e ribnicës) pranë Podgoricës.

Sado, që të dy këta njiheshin si gjeneralët më barbarë dhe antishqiptarët më të tërbuar, përkundër numrit të madh të ushtarëve që kishin tubuar, në luftimet e zhvilluara edhe trup më trup me malësorët e udhëhequr nga Bajram Curri, do të vriteshin rreth 350 ushtar sllav dhe 80 kryengritës shqiptar,21 prej të cilëve, vetëm nga fshati Shipshan, ku Bajram Curri kishte vendosur shtabin e tij të luftës.

Ndaj falë trimërisë së pa shoqe të malësorëve, dhe strategjisë shembullore luftarake të udhëhequr nga Bajram Currit, pas një lufte të pareshtur heroike, në fillim të tetorit të vitit 1913, kryengritësit

shqiptar, do ta përzinin përfundimisht ushtrinë pushtuese serbo-malazeze nga Malësia.

Luftërat e brendshme

Nga 7 mars deri më 3 shtator të vitit 1914, Shqipëria londineze, sipas vendimit të Fuqive të Mëdha, do të udhëhiqej nga administrata e princit gjerman Otto Wilhelm Wid, ndërsa Kosova dhe trojet tjera etnike, të cilat sipas vendimit nga 29 korriku i vitit 1913 në Konferencën e Londrës, ato mbetën nën pushtimin e Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë dhe përjetonin vështirësitë më të mëdha, në gjithë historinë e ekzistencës së tyre.

Ndaj, prijësit e mirënjohur të Popullit Shqiptar, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Buletini etj., të cilët pas kryengritjes në vjeshtë të vitit 1913, ishin detyruar të largoheshin nga Kosova, për çlirimin e saj dhe të viseve tjera nën pushtim, bënë përgatitjet përfundimtare për fillimin e një kryengritje të re çlirimtare, kundër okupatorëve sllav.

Por, në korrikun e vitit 1914, zëri i Atdheut, Bajram Curri do ta thërriste sërish, për aksion në Koplik e Mirditë, për mbrojtjen e vendit nga ndërhyrjet serbe edhe brenda kufijve të shtetit amë.

Ndaj, vetëm pas vrasjes së princit Austro-Hungarez, Franc Ferdinandi më 28 korrik të vitit 1914 në Sarajevë, nga një kriminel serb (Gavrillo Princip), rast i cili do të bëhej shkas për fillimin e luftës së parë botërore dhe futjen e Serbisë në luftë me Austro-Hungarin, Hasan Prishtina do ta braktiste postin e ministrit, të postë-telegrafëve në qeverinë shqiptare të Turhan Pashës, atëbotë me seli në Durrës dhe vendosej menjëherë në Shqipërinë veriore për organizimin e një kryengritjeje të re çlirimtare në Kosovë.

Luftës që do të fillonte më 6 gusht të vitit 1914, në fshatin Zhur afër pikës kufitare të Morinës do ti bashkohej edhe Bajram Curri e Isa Buletini, të cilët do ta shkatërronin plotësisht garnizonin serb të vendosur aty, për të vazhduar betejën deri në hyrje të Prizrenit, por pas mbarimit të municioneve dhe mungesës së furnizimeve nga shteti amë, me gjithë përpjekjet, kryengritësit shqiptar nuk mundën të shkonin më tej, as bënë më shumë për vendin e tyre.

Edhe me këtë rast, megjithëse shqiptarët bënë luftë të drejtë dhe për çlirimin e vendit të vet, qeveria serbe e asaj kohe, nuk do të ngurronte të ankohej, jo vetëm tek qeveria e Turhan Pashës në Durrës, por pothuajse edhe në të gjitha kryeqytetet Evropiane.

Internimi në Austri

Pa kaluar shumë kohë, ushtria serbe do ndiqej nga forcat Austro-Hungareze, kurse pas ardhjes së tyre në trojet shqiptare, Bajram Curri do të kthehej sërish në Kosovë, ku përveç hapjes së shumë shkollave në gjuhën shqipe, ai do të përpiqej të bënte edhe përgatitjen e popullsisë shqiptare atje, për kryengritje të reja kundër rikthimit të forcave pushtuese serbe, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Përpyekjet e tij, u ranë në sy organeve austro-hungareze, ndaj ato edhe e internuan Bajram Currin për rreth dy vite me radhë, në Austri, prej nga ai do të kthehej, vetëm pas largimit të trupave Austro-Hungareze nga Shqipëria.

Pas kthimit të heroit në vend, edhe pse tanimë Lufta e Parë Botërore kishte përfunduar, trojet shqiptare të cilat nuk kishin ushtri të veten, as çfarëdo forcash të organizuara mbrojtëse, mbetën përsëri të copëtuara dhe shpërndara gjithandej, nën pushtimin e shteteve hegjemoniste fqinje, si Greqia dhe Serbia, pa përjashtuar edhe Italinë e cila deri në vitin 1920, mbajti të okupuar me forcë, qytetin historik bregdetar të Vlorës me rrethinë.

Formimi i Komitetit të Kosovës

Fatkeqësia që goditi popullin shqiptar, pas vendimeve të padrejta të Fuqive të mëdha për copëtimin e trojeve të tyre, irritoi shumë luftëtar të ditëve të para për çlirim kombëtar, të cilët nuk u pajtuan kurrë me pushtimin e atdheut nga shtetet hegjemoniste fqinje dhe ri-okupimin e Kosovës nga Serbia.

Në vazhden e përpjekjeve për mbështetjen e Çështjes Kombëtare ,çlirimin e trojeve tona të pushtuara etnike si dhe bashkimin e të gjithë atyre me Shqipërinë, më 1 Maj të vitit 1918, në Shkodër u krijua "Komiteti Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën pushtim“ i cili edhe mori përsipër daljen zot tokave të okupuara kudo.

Anëtar i devotshëm i këtij komiteti, ishte edhe heroit Bajram Curri, ndihmesa e gjithanshme e të cilit, nuk pushoi asnjëherë, deri në ditën e rënies së tij të dhembshme.

Po ky Komitet e ngarkoi Bajram Currin edhe me detyrën e mbrojtjes së çështjes shqiptare, si i deleguar në Konferencën e Paqes më 1919,në Paris, i cili këto dhe shumë detyra tjera me rëndësi, do ti kryente gjithmonë e në çdo kohë, me dinjitet të lartë dhe devotshmëri të rrallë.

Por, përveç mbetjes nën pushtim të huaj, shqetësim më vete për anëtarët e këtij Komiteti dhe shumicën e popullit tonë kudo, pa dyshim, ngjalli nënshkrimi i marrëveshjes turko-jugosllavo-greke e vitit 1919, për shpërnguljen e shqiptarëve me dhunë nga viset e pushtuara dhe zhvendosjen e tyre në Anadoll, fakt i cili e detyroi “Komitetin e Kosovës” të kryesuar nga Kadri Prishtina, që t’u drejtohej SHBA-ve, për ndihmë dhe mbrojtjen e bashkëkombësve nga asgjësimi, nën pushtimin sllavo-grek.

Qeverie e Lushnjës

“Komitet Kombëtar i Kosovës”, i cili udhëhiqej nga ajka e heronjve më të shquar kombëtar, do të ngrinte zërin, sa herë pati nevojë edhe kundër qeveris së Durrësit, me në krye Turhan Pashën.

Madje, ky Komitet dha ndihmesën kryesore edhe për organizimin e Kongresit të Lushnjës, nga 21-31 janar 1920, në të cilin kryeministër i Shtetit do të zgjidhej patrioti Sylejman Delvina, kurse ministër i drejtësisë udhëheqësi i “Komitetit Kombëtar”, Kadri Prishtina, i cili si jurist profesionist që ishte, pati barrën kryesore për përgatitjen dhe jetësimin e akteve më të larta kushtetuese e shtetërore të Shqipërisë së Pavarur, të cilat i realizoi me shumë sukses.

Nga Qeveria e Lushnjës, ministër pa portofol dhe komandant i forcave të luftës, do të zgjidhej edhe Bajram Curri, e këtë jo pa krejt rastësisht dhe pa qëllim, ngase Qeveria e sapo-zgjedhur dhe ende e pa konsoliduar si duhet, ishte e pafuqishme të organizonte çlirimin e vendit, pjesë të mëdha të të cilit edhe mbi dy vjet pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ende mbaheshin të pushtuara nga shtetet hegjemoniste fqinje, kurse Vlora me rrethinë, siç u çek edhe më lartë, ishte e okupuar nga Italia.

Ndaj, në këtë gjendje, çlirimin e Vlorës, do ta merrte përsipër “Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare” i cili sipas historianit Dr. Xheladin Shala, në emisionin TARGET të RTK-s, datë 07. 08. 2013, ishte degë e “Komitetit të Mbrojtjes së Kosovës dhe Viseve Shqiptare nën pushtim”.

Mbështetjen e pakursyer të Bajram Currit në arritjen e konsolidimit të pavarësisë së Shqipërisë, do ta gëzonte deri në fund edhe qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Heroi ynë, dinte të ishte gjithmonë aty ku e kërkonin rastet, ngjarjet e kohës dhe nevojat e vendit i cili me atdhetarizmin e tij të kulluar, ndihmoi kudo që mundi duke dëshmuar

edhe aftësi të përkryer për udhëheqje prej strategu të luftës së devotshme kombëtare, të cilën ai përherë e pati në plan të parë.

Derisa Bajram Curri, si pjesë e këtij Komiteti, atëkohë zhvillonte luftime kundër forcave të Esad pashës, ushtria jugosllave vazhdonte operacionet e saj më të ashpra në Kosovë, kurse një numër i madh trupash të saj, ishte grumbulluar matanë lumit Buna, pranë Shkodrës, dhe prisnin të gatshme të ndërhynin edhe në Shqipëri.

Ndaj, pa kaluar shumë kohë, nga fundi i muajit korrik të vitit 1920, trupat jugosllave do të kalonin kufirin, pushtonin Kastratin dhe niseshin në drejtim të Shkodrës, me ç 'rast në Koplak do tu dilnin përpara forcat e bashkuara të Bajram Currit dhe Ahmet Zogut, duke mundur me sukses, trupat pushtuese serbo-malazeze dhe kthyer mbrapa forcat agresore.

Bajram Curri, kundër trupave jugosllave, do të luftonte edhe në verilindje të Shqipërisë, në malësitë e Kelmendit, Gjakovës, krahinën e Hasit, Kukësit dhe të Dibrës, bashkë me Elez Isufin, sepse edhe pas vitit 1920, të gjitha këto krahina megjithëse brenda kufijve të Shqipërisë londineze, ende mbaheshin të pushtuara nga serbët.

Mospajtimi me Konferencën e Versajës

Në Ballkan e më gjerë, sa vuanin shqiptarët në trojet e copëtuara dhe të pushtuara nga shtetet fqinje të cilat synonin shfarosjen e tyre, nuk kishte edhe një komb tjetër në këto pjesë të Ballkanit dhe Evropës.

Ndaj, aktet e konferencës së Versajës, të cilat edhe pas Luftës së Parë Botërore, lanë popullin dhe trojet tona të ndara dhe nën okupim të huaj, që më së tepërmi rëndonin mbi ne, siç ishin të papranueshme për shqiptarët, me to nuk u pajtuan edhe disa popuj të tjerë si dhe udhëheqësit e tyre, në mesin e të cilëve ishte edhe intelektual, letrari dhe ushtaraku i lartë italian, Gabriele D'Annunzio (1863-1938).

Po ky shkrimtar, intelektual, poet, luftëtar dhe udhëheqës i shquar nga vendi Adriatik, i frustruar me vendimin e datës 10 shtator të vitit 1919, të Konferencës së Versajës , për kalimin e Rjekës me rrethinë-nën sovranitetin e Kroacisë, atëbotë, mbretërisë së SKS, (serbëve-kroatëve dhe sllovenëve) po atë muaj, në shenjë proteste, me vullnetarët e vet, ai do ta pushtonte tërësisht këtë qytet bregdetar.

Madje, sipas shënimeve të Eqrem bej Vlorës, në vëllimin e II-t, të kujtimeve të tij, botuar më 2001 në Tiranë, Gabriele D'Annunzio, në vitin 1920, do të organizonte në Trieste të Italisë edhe një tubim të madh të të gjitha organizatave kombëtare, popujt e të cilëve kishin

rënë nën sundimin jugosllav, dhe ishin të gatshëm të luftonin për çlirimin e tokave të tyre nga ky shtet okupues.

Ndaj, me pëlqimin e Bajram Currit dhe vendimin e "Komitetit të Kosovës", përfaqësues i shqiptarëve në konferencën e lartcekur, do të dërgohej pjesëtari i këtij komiteti dhe nipi i Sylejman Vokshit, Beqir Vokshi, i cili nga Gabriele D'Annunzio, po në atë tubim, do të merrte premtimin, se pa vonuar, shqiptarëve të Kosovës ,ai do tu dërgonte një anije me armatim e municione, në mbështetje të luftës së drejtë që ata bënin, për çlirimin e vendit të tyre nga sllavët. (*Eqrem bej Vlora, Kujtime, vëllimi II, SHLK, Tiranë 2001*)

Ishte koha kur Populli Shqiptar i Kosovës, i pakënaqur me vendimet e konferencës së ashtuquajtur të paqes në Versajë, e cila edhe pas luftës së parë botërore, la trojet e tij nën pushtimin serb, kryengritjen e filluar nga viti 1919,me në krye Azem Bejtën dhe Sadik Ramën, vazhdonte ta rriste e zgjeronte gjithandej, duke ngritur në këmbë mese 10 mijë luftëtar, në Rrafsh të Dukagjinit dhe Drenicë.

Atëkohë, Qeveria serbe kishte ndërmarrë një ofensivë të ashpër kundër kryengritësve shqiptar, kurse ata me gjithë vullnetin e fortë për të qëndruar deri në fund, në mungesë të armëve dhe municionit, nuk kishin me çfarë të luftonin, ndaj dhe prisnin mbështetje nga "Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës" me seli në Shkodër dhe Shteti amë Shqipëria.

Luftëtar i konsolidimit të shtetit shqiptar

Veprimtaria atdhetare e “Komitetit për mbrojtjen e Kosovës” në përgjithësi dhe gatishmëria vetëmohuese e Bajram Currit në veçanti, u dëshmuar në të gjitha kohët dhe ngjarjet madhore të popullit tonë, si në jetën politike, ashtu edhe në atë shoqërore shqiptare. Mbështetja e tij, në çdo vend dhe ngjarje me rëndësi kombëtare, qe gjithmonë e pranishme, por me gjithë vullnetin e madhe që kishte të ndihmonte kudo që paraqitej nevoja, nga pengesat e shumta që i bëheshin, as ai nuk arriti gjithmonë të qonte ndihmesën e tij , atje ku dëshironte dhe më së shumti kërkohet.

Moto e tij ishte “Një për të gjithë, të gjithë për një!”. (Marenglen Verli)

Fatkeqësisht, në ato vite të rënda për kombin edhe vet Shqipëria, rrezikohej nga të gjitha anët. Madje, kërcënimet asokohe, asaj i vinin jo vetëm nga jashtë por edhe brenda për brenda vendit.

Kështu ndodhi edhe më 13 prill të vitit 1920 , kur në prag të luftës së Vlorës, Esad Pashë Toptani ndërmerr një përpjekje të re (të fundit) me dhunë për t'u bërë mbret i Shqipërisë së mesme, Bajram Curri do të ftohej nga vet Ahmet Zogu për goditjen e forcave tradhtare të esadistëve në Shqipërinë e Mesme.(*Astrit Lulushi, Atentate nga Parisi në Tiranë, 13 Prill 2014 blogs.voanews.com*)

Për aq më keq, sipas citimit të disa historianëve shqiptar, në emisionin e **RTK-s, TARGET të datës 07 korrik 2013**, në çastet më kritike për fatet e atdheut dhe mu në ditët kur Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) ishte në përfundim të përgatitjes së projektit për pranimin e Shqipërisë në “Lidhjen e Kombeve”,**konstruksioni i Marka Gjonit**, inspiruar nga Nikolla Pashiqi, më 17 korrik të vitit 1921,do të shpallte në Prizren të ashtuquajturën “republikë” të Mirditës.

Madje, kur për mbrojtjen e kësaj krijese separatiste dhe armiqësore, brenda kufijve të Shqipërisë do të intervenonin me forcë trupat e armatosura serbe,Bajram Curri si patriot i flakët që ishte, u përgjigj dhe luftoi edhe me këtë rast, ashtu siç i ka hije një atdhetari të vërtetë dhe të devotshëm kombëtar.

Para një rreziku të tillë që kërcënonte vet ekzistencën e shtetit dhe genies kombëtare , Qeveria Shqiptare do ti drejtohej edhe një herë Bajram Currit për ndihmë, i cili thirrjes së saj do ti përgjigjej me ndjesitë më të çiltra atdhetare, dhe përkundër sjelljeve të Ahmet Zogut, ai do të bashkonte forcat me të, duke mundur trupat serbe dhe shkatërruar agjenturën e Pashiqit në Mirditë.

Pra, përkundër qëndrimeve thujse vazhdimisht armiqësore të Ahmet Zogut,ndaj Plakut të Maleve, kur më 17 korrik të vitit 1921, Zyra Jugosllave e Shtypit në Prizren, njoftonte thirrjen e të ashtuquajturës “Republikë e Mirditës” së Marka Gjonit, me ç`rast ushtria jugosllave do të hynte edhe brenda kufijve të Shqipërisë, për mbrojtjen me forcë të kësaj krijese armiqësore, të shpallur nga separatistët, Bajram Curri do ti përgjigjej me shpirt e zemër, thirrjes së Qeverisë Shqiptare për luftimin e ushtrisë pushtuese sllave, që kishte invaduar tokat kombëtare.

Për hire të atdheut, ai bashkërendoi aq mirë luftimet me Ahmet Zogun, sa që me një ushtri të vogël bënë mrekulli të mëdha duke thyer forcat e agresionit jugosllav, do të theksonte ndër të tjera Kastriot

Dervishi tek shkrimi (“*Si u vra Beqiri, nipi i Sulejman Vokshit*”
www.forumishqiptar.com)

Madje, dr. Marenglen Verli, shkruan; Ende pa marrë veten nga aksionet e lartcekura, Bajram Currit iu kërkua që të spastronte intervenimin e forcave serbe në Koplik afër Shkodrës. Kurse një vit me vonë, u ftua të hidhej edhe në një aksion tjetër kombëtar, për asgjësimin e agjunkturës së Nikolla Pashiqit, në Mirditë, të kryesuar nga Marka Gjoni, kapedani separatist i krahinës. (*Marenglen Verli, “Bajram Curri, tribun i vegjëlisë”*)

Pra për mbijetesën e shtetit të brishtë shqiptar, të rrezikuar brenda e jashtë dhe atakuar nga të gjitha anët, u deshën aq shumë beteja të ashpra e të njëpasnjëshme dhe luftime të pareshtura për çdo pëllëmbë toke të tij, sa që pa veprimet e Komitetit Kombëtar, Shqipëria e atyre moteve, as që mendohet se mund të qëndronte apo edhe ekzistonte si shtet.

Ndaj, pa asnjë dyshim, në kohën kur pjesë të mëdha të vendit edhe mbi dy vjet pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ende mbaheshin të pushtuara nga shtetet fqinje, rol parësor pati “Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare“, dhe udhëheqësit e mirënjohur popullor të tij si Bajram Curri, falë luftërave dhe përpjekjeve vetëmohuese të të cilëve, më 9 nëntor të vitit 1921, tokat e pushtuara brenda vendit, përfundimisht do të çliroheshin dhe arrihej vendosja e kufijve të Shqipërisë londineze.

Ftohja e marrëdhënieve dhe prishja me Ahmet Zogun

Hasan Prishtina dhe Bajram Curri, që nga fillimi i luftës së përgjithshme për çlirim, të dy, ishin udhëheqësit kryesor të betejave dhe aksioneve çlirimtare, kudo frymohej shqip, por me mbetjen e mbi gjysmës së trojeve shqiptare nën pushtimin sllavo-grek, ata nuk do të ndjeheshin mirë, më asnjëherë.

Lufta në Kosovë, si pjesa më kryengritëse e Shqipërisë Etnike, kishte filluar qysh para Kongresit të Berlinit dhe marrë hov e shtrirë gjithandej, sidomos pas formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për të mos u shuar më asnjëherë deri në çlirimin e plotë dhe përfundimtar të trojeve shqiptare nga Perandoria osmane.

Madje, edhe në ato vite të vështira, kur qeveria ende e pa-konsoliduar shqiptare, nuk kishte mundësi as interesimin e duhur që të merrej seriozisht me problemet e tokave të pushtuara kombëtare brenda kufijve të Shqipërisë, dhe atyre të mbetura jashtë kufijve të shtetit

amë, "Komiteti Kombëtar i Kosovës" nga ana e Gabriele D'Annunzios, vërtetë ashtu siç ishte premtuar prej tij, që në verën e vitit 1920, pranoi një anije me armatim, e cila do të arrinte në Shëngjin, mu në ditë kur lufta në Vlorë kishte marrë përmasat e saj më të mëdha.

Në të njëjtën kohë, ushtria jugosllave vazhdonte operacionet e ashpra në trojet e pushtuara shqiptare, por, fatkeqësisht edhe përkundër zhvillimeve dramatike në Kosovë, Ahmet Zogu ,atëherë ministër i brendshëm, nuk lejoi zbarkimin e anijes me armatim e municion-dedikuar kryengritësve në Kosovë, që atyre aq shumë u duheshin në ato momente të rënda lufte e qëndrese.

Por, sipas kujtimeve të Sejfi Vllamasit, Zogu do ta dërgonte Xhemajl Naipin dhe Sejfi Vllamasin, me 20 mijë franga ari në dorë, për ta bindur Bajram Currin që të mos pranonte, armatimin e ardhur.

Bajram Curri si patriot i denjë e i pa epur dhe njeri i pa-korruptuar që ishte, siç do të vërente me të drejtë edhe prof. dr. Marenglen Verli në shkrimet e tij, bashkë me Bedri Pejanin, hodhën poshtë kategorikisht paratë e ofruara nga Zogu.

Ata donin me çdo kusht ta ndihmonin luftën e Kosovës, dhe me armatimin e dedikuar asaj, ti pajisnin qindra e mijëra kryengritës të cilët atë kohë prisnin me pa durim mbështetje dhe kishin var të gjitha shpresat tek "Komiteti Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës" nënkryetar i të cilit ishte Bajram Curri.

Nga citimi i kujtimeve të shkruara të Sejfi Vllamasit, mësojmë se Sejfiu dhe Xhemajl Naipi, po atë natë, me urdhër të Ahmet Zogut, nga Bajram Curri do të shkonin te ndihmës prefekti i Shkodrës **Sulçe Bushati** dhe komandanti i xhandarmërisë **Malë Bushati**, për ti informuar ata mbi qëndrimet e Bajram Currit dhe përcjellë atyre urdhrin e Ahmet Zogut, që të ndërmerinin masat më të rrepta ushtarake dhe dërgonin kapiten **Hasan Bushatin**, me forca të mëdha xhandarmërie, për të penguar me çdo kusht, shkarkimin e anijes me armë e municione, dedikuar luftës së Kosovës.

Ndaj, meqenëse atë kohë, ofensivat e pareshtura serbe mbi popullsinë shqiptare nuk pushonin, kurse forcat kryengritëse në Kosovë mu në valën e luftimeve më të rrepta të cilat zhvilloheshin pa ndërprerë, patën aq shumë mungesë armatimesh e municioni, të cilat edhe pse erdhën në vendin e premtuar, nuk u lejuan tu kalonin atyre, nga ky rast, do të fillonin fërkimet e para serioze dhe ftohja e njëmendët e

marrëdhëniet ndërmjet Bajram Currit dhe Ahmet Zogut. (*Sejfi Vllamasi, "ballafaqime politike në Shqipëri", Neraida*)

Megjithatë, lufta për çlirim, në Kosovë nuk kishte të ndalur, madje çetat e kryengritësve shqiptarë me në krye Sadik Ramën dhe Azem Bejtën, sipas udhëzimeve të "Komitetit Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës", në prill të vitit 1921, do të përqendroheshin në shumë pjesë të saj, ku vazhdonin pareshtur sulmet kundër xhandarmërisë dhe ushtrisë pushtuese serbe dhe bënin përpjekje mbinjerëzore për organizimin e një kryengritje të përgjithshme popullore.

Kurse, nga 17 deri më 19 qershor 1921, kur forca të mëdha serbe kishin mësyre zonën neutrale të Junikut, për tri ditë e net me radhë, burrat e Kosovës, përkundër mungesës së madhe të armëve dhe municionit, do të luftonin *trimërisht*, kundër forcave pushtuese edhe atje, për mbrojtjen e kësaj Zone të lirë.

Por, mjerisht, nuk do të vononte shumë, dhe fushata e egër kundër krerëve të "Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës" dhe udhëheqësve më të njohur shqiptarë, përveç në Kosovë dhe Zonën neutrale të Junikut, do të merrte hov edhe brenda në Shqipëri, nga tipa kriminelësh dhe tradhtarësh kombëtar të prirë nga Cano beg Kryeziu.

Qeveria e Hasan Prishtinës, 7-12 dhjetor 1921

Veprimtaria atdhetare e Bajram Currit u dëshmuar në të gjitha ngjarjet kryesore kombëtare në jetën politike dhe shoqërore shqiptare. Mbështetja e tij që gjithmonë e pranishme si në luftërat për liri, ashtu edhe në përpjekjet e viteve 1920-1924 për konsolidimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar, edhe pse në një Shqipëri të cunuar, ku mungonte Kosova, Çamëria, Ilirida dhe shumë troje tjera shqiptare, për të cilat zemra e kombit do të rrah e mundohet gjithmonë, derisa të ketë edhe një shqiptar të vetëm mbi tokë.

Por, përkundër rreziqeve të jashtme dhe të brendshme që kërcënonin pareshtur Shtetin Shqiptar, parti dhe grupe konkurrense për qeverisjen e vendit, pothuajse nuk gjetën asnjëherë mirëkuptim ndërmjet veti, dhe as e lanë vendin në qetësi. Kështu pas trazimeve të shpeshta në qeverisje, më 7 dhjetor të vitit 1921, kryeministër do të emërohej Hasan Prishtina, i cili vetëm 5 ditë më vonë, për të mos e futur vendin në vëllavrasje, do të detyrohej të ipte dorëheqje si kryeministër nga kërcënimet për luftë ndërshqiptare të Ahmet Zogut dhe mbështetësve të tij, ngjarje e cila edhe atëherë konsiderohej si goditje e rëndë për stabilitetin e vendit.

Madje, përkundër gjithë ndihmesës që dha “Komiteti Kombëtar” përfshi edhe përpjekjet e mëdha të heroit Bajram Curri për ruajtjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, nga fundi i vitit 1921, Ahmet Zogu do të orientohej në mbështetës të tjerë, të cilët kishin lidhje të forta me qeverinë serbe të Nikolla Pashiqit në Beograd.

Ndaj, për fillim, në vitin 1921, Zogu do ta fejonte motrën e tij të dytë- Nafijen, me Cena beg Kryeziun e Gjakovës, i cili ishte kryesues i një partie serbe dhe njihej si agjent i Qeveris së Pashiqit, emëruar nga pushtuesi jugosllav, që më 1918, kryetar i Gjakovës.

Kurse, nga viti 1922, Ceno beg Kryeziun i cili ende udhëhiqte partinë serbe të Ljuba Davidoviqit për Gjakovën, dhe qytetin e tij të lindjes, si mik i ngushtë dhe bashkëpunëtori më besnik i Nikolla Pashiqit, Zogu do ta sillte në Krumë dhe emëronte kryetar të prefekturës së Kosovës.

Cano beg Kryeziu kishte kohë që i sillte dëme të mëdha çështjes shqiptare dhe çlirimit të trojeve të pushtuara nga sllavët edhe para ardhjes së tij në Krumë, ndaj Bajram Curri, qysh herët, pati rënë në hasmëri të hapur me të.

Madje armiqësia familjare me kryezinjt datonte që nga fërkimet me të atin e Cana begut, Riza Beg Kryeziut, që me përjashtime të vogla, pothuajse pareshtur e luftoi Bajram Currit, të cilit i pati prish edhe kullat në Gjakovë, dhe pas djegies së tyre, sipas këngës popullore, ai edhe nëpërmjet zaptive i qonte fjalë Plakut të Maleve, që të mos provonte të kthehej më në Gjakovë, por të rrinte në Has e Dragobi, duke e kërcënuar se nuk kishte më vend për të aty.

Shko kallëzoni ati Begut të ri

Thuaj rri në Has e në Dragobi

Se në Gjakovë nuk ka vend për Ty

Bajrush Doda “Bajram Begu”

<https://www.youtube.com/watch?v=iFrvW4y3s7w>

Për aq më keq, tanimë forcat reaksionare në marrëveshje me qeverinë e Serbisë, kishin urdhëruar edhe shuarjen e “Komitetit për mbrojtjen e Kosovës” si dhe eliminimin e Bajram Currit e Hasan Prishtinës, gjë që e bënte situatën edhe më të vështirë dhe eksplozive, për ç’shkak, Azem Bejta do t’u çonte porosi të prerë, Ahmet Zogut dhe pasuesve të tij, se po u mungoi vetëm një fije floku Hasan Prishtinës dhe Bajram

Currit, ai do t'i vriste rrugëve autorët dhe urdhërdhënësit, e këtyre akteve antikombëtare, që ata planifikonin.

Ndaj marrëdhëniet mes Zogut dhe Bajram Currit nga marsi i vitit 1922 do të ktheheshin në konfrontime të hapura, deri te përdorimi i armëve, duke i shndërruar ata përfundimisht në rival të pa-pajtuar, që nuk do ta duronin më njëri-tjetrin asnjëherë, edhe pse kishin një të kaluar që i lidhte me sukseset e mbrojtjes së vendit dhe ndërtimin e shtetit, gjatë viteve më kritike të ekzistencës së tij.

Lufta e Krumës Krijimi i terrenit për luftë ndërshqiptare

Ëndërrues i pandreqshëm i Shqipërisë Etnike!

Qëndrimet antikombëtare të Qeverisë së Ahmet Zogut, me vendosjen e Cano beg Kryeziut për udhëheqës të Krumës dhe gjithë prefekturës së Kosovës, i dhanë fuqi zjarrit konfrontues edhe më tepër si dhe krijuan vërtetë terren të nxehtë për luftë ndërshqiptare.

Qeveria zogiste, jo vetëm se nuk mbështeste më aspiratat kombëtare të shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1913, por edhe luftonte ato në mënyrën më të ashpër dhe me të gjitha mekanizmat shtetëror.

Veprimet gjithnjë e më afruese të Ahmet Zogut me bashkëpunëtorët e Serbisë, të cilat sa vinin e forcoheshin, acaronin në masë të madhe gjendjen dhe gjithnjë e më tepër e qonin atë para shpërthimit.

Në vitin 1922, qeveria e ndikuar nga Zogu, do të vendoste edhe marrëdhënie diplomatike me qeverinë serbo-kroato-sllovene, akt i cili pati pasoja të rënda, sidomos për udhëheqësit nga Kosova.

Qeveria e udhëhequr nga Xhafer Ypi, i cili në Prillin e vitit 1939, pas ikjes së Zogut nga vendi, nuk do të nguronte të përshëndeste edhe pushtimin e Shqipërisë nga fashistët italianë, përveç heqjes së të drejtës atdhetarëve të Kosovës, për ushtrimin e detyrës së deputetit në kuvendin e shtetit, tanimë ajo kishe lidhur edhe një marrëveshje të veçantë me qeverinë jugosllave, për ndjekjen e përbashkët të udhëheqësve më sublim kombëtar nga Kosova, duke i dhënë leje ushtrisë serbe të hynte edhe brenda territorit të Shqipërisë për eliminimin e tyre.

Kurse Ahmet Zogu, icili asokohe ishte ende ministër i brendshëm, vendimet kontroverse të kryeministrit Xhafer Ypi, përpiquej me çdo kusht ti jetësonte, kështu që marrëdhëniet e ashpërsuara ndërmjet

Bajram Currit dhe Ahmet Zogut, do të thyheshin pariparueshëm dhe pa dëshirën e heroit, ato do të shndërroheshin përfundimisht në luftë për mbijetesën e Bajram Currit dhe patriotëve tjerë të shquar nga Kosova.

Ndaj, nga ai moment, Hasan Prishtina dhe Bajram Curri, do të strehoheshin në veri të vendit, prej nga në mars të vitit 1922, organizuan një kryengritje, por pas ndërhyrjes së ambasadorit britanik në Shqipëri, **Harry Eyres**, njëri nga udhëheqësit e lartë do të tradhtonte kryengritjen, dhe dështonte vazhdimi i saj.

Hasan Prishtina dhe Bajram Curri, dy burra të shquar të kombit që jetuan e vepruan në kohë dhe gjendje të jashtëzakonshme, si luftëtar të ditëve të para, megjithëse u ballafaquan me të gjitha llojet e vështirësive më të mëdha që njih jeta e njeriut, ata nuk u pajtuan kurrë me pushtimin e trojeve tona etnike nga shtetet hegjemoniste fqinje, ndaj rreth 11 muaj më vonë, aty nga fundi i shkurtit të vitit 1923, heronjtë tanë organizuan edhe një kryengritje në Kosovë, kundër okupimit serb të saj.

Por, megjithëse kjo kryengritje zhvillohej në trojet e pushtuara të atdheut nga serbët, ajo, jo vetëm se nuk u ndihmua, por edhe u pengua me të gjitha forcat nga qeveria e Ahmet Zogut, i cili nga 2 dhjetori i vitit 1922, ishte emëruar kryeministër i Shqipërisë.

Kryengritja e qershorit 1924

Pas ndërrimeve të serishme dhe të njëpasnjëshme të qeverive, Zogu i emëruar kryeministër, para pak më tepër se një viti e gjysmë, gjatë gjithë kohës, do të bënte gjithçka për të forcuar pozitat e tij dhe ngjitur sa më lart në pushtet. Madje përveç manipulimit me vota, ai do të organizonte edhe eliminimin e kundërshtarëve politik, duke mos ngurruar të vriste edhe Avni Rustemin, më 22 prill të vitit 1924.

Ndaj të gjendur mes dy zjarresh dhe nën goditje të gjithanshme, atdhetarët e shquar të vendit, pa kular shumë kohë dhe vetëm pas pak më tepër se një viti, derisa Bajram Curri qëndronte ende i strehuar maleve për t'iu shmangur forcave zogiste, me thirrjen e tij, drejtuar shqiptarëve në pranverën e vitit 1924, për të kapur armët, flakët e ndezura të luftës, do të shpërthenin sërish, dhe tanimë në Shqipëri, kundër qeverisë së Ahmet Zogut.

Lojërat e Zogut me fatin e popullit të vet, quan shqiptarët e dëshpëruar në kryengritje brenda shtetit të tyre. Kryengritja filloi më 24 maj të vitit 1924 në Has, me pikënisje Krumën, të cilën kryengritësit e

udhëhequr nga Bajram Curri do ta merrnin me 25 maj të ati viti për të kaluar me shpejtësi në Lumë, Dibër dhe Mat, kurse më 10 qershor të vitit 1924, do të merrnin edhe Tiranën, duke mundur forcat e Ahmet Zogut, dhe rrëzuar qeverinë e tij.

Ndaj, në qershorin e vitit 1924, Ahmet Zogun, Cano beg Kryeziu dhe disa oficerë si: Zef Ndoci, Maliq Bushati, Luigj Shantoja, Marka Gjoni, Tafë Kaziu e të tjerë, ikin në Jugosllavi, në strolullin e përgatitur enkas për miq si ai, nga Nikolla Pashiqi. (*Gjurmime Albanologjike* 2, f. 233 / Prishtinë 1965.

www.albaniaonline.tv/noname-11.html)

Amaneti i Bajram Currit

Gjatë gjithë përpjekjeve kombëtare e luftarake, Bajram Curri në Has dhe me hasjanët, do të kalonte vitet më të mira të jetës dhe veprimtarisë së tij të gjatë atdhetare. Madje, siç dihet historikisht, ai edhe aksionet më të ndritshme luftarake i nisi dhe realizoi në Has.

Luftën e nisur nga Hasi, Heroi do ta qonte me sukses të admirueshëm deri në Shkup, ish kryeqytetin e Dardanisë, ku do ta kurorëzonte njëherë nga fitoret më sublime kombëtare me shkëlqim të plotë.

Të gjithë banorët e Hasit pa dallim, ishin mësuar dhe mishëruar aq shumë me këtë Hero Kombëtar, sa që sipas rrëfimeve të pleqve, pati momente kur pushtuesit serb por edhe pushtetarët vendor të Ahmet Zogut, xhandarmëria e të cilit, udhëhiqej nga nxënësit më besnik të Nikolla Pashiqit si Cena beg Kryeziu, Muharrem Bajraktari, Kadri Mehmeti etj., uli hasjanët midis prushit të zjarrit, në vatrën e ndezur, dhe ata u dogjën të gjallë, por nuk tradhtuan asnjëherë dhe për asnjë çmim Bajram Currit, edhe kur ishte në pyetje vet jeta e tyre.

Në mesin e familjeve të kësaj treve e më gjerë, që përherë u dalluan për mikpritje dhe mbështetjen e pa-rezervë ndaj Bajram Currit, njihet shtëpia bujare e Salih Qarrit të Hasit.

Sipas historive që edhe sot tregohen, kjo familje përherë u dallua për bukëdhënie e bamirësi në disa krahina, e cila nga njerëz të anëve të ndryshme ende mbahet mend dhe përmendet me nostalgji për sofrën e saj të shtruar me bukë, dit e natë, si për luftëtarët e kombit, miq e dashamirë, ashtu edhe për mysafir e rrugëtar të rastit, që ato kohë kalonin andej.

Bajram Curri, qoftë për faktin se edhe vet familja e Salih Qarrit, kishte prejardhjen nga Kolgecaj (sot qyteti Bajram Curr) i Malësisë, dhe i takonte fisit Krasniqe njëjtë si Bajram Curri, gjendjes së saj të mirë

ekonomike asokohe, afërsisë së gjakut me të, apo edhe mikpritjes me zemërgjerësi të pakursyer që ofronte kjo shtëpi bujare, ai dhe prijësit e Krasniqes si Zeqir Halili, selinë e tyre gjithmonë e patën në konakun e Salih Qarrit, asokohe zot shtëpie.

Salihu, kishte marrëdhënie të mira edhe me Hysen Selmanin, të cilin megjithëse e kishte fqinj me tokë dhe shtëpi, Hyseni i përkiste fisit të Bytyqit, por si dashamir i Bajram Currit që ishte, ai tubonte parinë e fisit të vet dhe mblidheshin në Kullën e Qarrit, ku për çdo kryengritje që udhëhiqte Bajram Curri, aty lidhnin besën me Plakun e Maleve, për luftë të përbashkët.

Ndaj, ashtu si në korrikun e vitit 1912, para se të fillonte sulmi mbi garnizonin turk, Bajram Curri njëjtë do të vepronte edhe në majin e vitit 1924, kur pak para kryengritjes, bashkë me qindra luftëtar do të vendoseshin, pushonin dhe ushqeheshin, në Kullat e familjes së Qarrit, e cila ndodhet në një pikë të rëndësishme strategjike, pikërisht ndërmjet Qafës së Prushit e qytetit të Krumës dhe buzë rrugës për Gjakovë.

Ndaj, pas një pritje të përzemërt dhe plot dashamirësi, kur pak kohë para sulmit në Krumë, në shtëpinë e Salih Qarrit, tuboheshin gjithnjë e më shumë luftëtar, dhe i zoti i shtëpisë Salih Qarri, do ti mbante të gjithë pjesëtarët e familjes së vet, nga 24 orë zgjuar e pa gjumë, duke gatuar ditë e natë, vetëm e vetëm, që të mos koriteshin e linin pa bukë, asnjë nga ushtarët e heroit, Plaku i Maleve do të ndjehej aq i prekur në shpirt, sa që natën e fundit, para sulmit në Krumë, Bajram Curri spontanisht kishte vendosur, që përfundimisht, ta linte **Amanetin historik, për varrimin e tij në Has!**

Dhe, siç tregojnë ende sot pleqtë dhe pasardhësit e kësaj familje bujare, por edhe Hysen Salihu, djali i Salih Qarrit, tanimë edhe ai në moshë të shtyrë, Bajram Curri para prijësve të luftës dhe burrave të mbledhur në Kullë, porosinë e fundit, do ta fillonte me këto fjalë:

“Burra, si kjo familje e nderuar edhe shumë shtëpi tjera në Has, rrinë natë e dit pa gjumë dhe gatuajnë nga 24 orë pareshtur për luftëtarët tanë.

Të gjithë na presin kështu, mirë e me shumë dashamirësi dhe ndjehen tepër të gëzuar, sa herë që ndajnë bukën e tyre me ne. Kjo është shenjë e mirë dhe më ka bindur përfundimisht, se “revolucionin ynë do të fitojë“.

Por, pasi që lufta jonë kësaj radhe është më ndryshe dhe populli ynë mjerisht është ndarë në dy grupe e taborë, madje partia tjetër ka edhe shkaun mbrapa, bashkë me shumë mercenarë, kam frikë se pa kaluar shumë kohë, shqiptarët mund të detyrohen të luftojnë ndërmjet veti, ndaj, para se të nisemi në aksion, të gjithë juve sa jeni këtu, dua t'ua them edhe dy tre fjalë, një porosi që ndoshta do të jetë e fundit për mu! E kjo është:

“Amanet për varrosjen time në Has”!

Kryengritësit kishin shtangë në vend, por heroit do të vazhdonte përsëri: **“ Që nga koha, kur kam filluar përpjekjet për këtë popull dhe vend timin, Hasi kurrë nuk më ka tradhtuar. Këtu, gjithmonë, si në ditë të mira edhe në ato më të vështirat, çdo herë gjeta mikpritje e mirëkuptim dhe mbështetje të pakushtëzuar si në asnjë vend tjetër. Askund nuk jam ndjerë më mirë, nuk kam fjet më rehat dhe as pushuar më qetë e sigurt, si në këto troje, vërtetë përherë besnike dhe bujare!**

Burra, ne jemi në luftë, dhe dekën e kemi më afër se këmishën e trupit, ndaj punës së ymrit nuk i dihet. Nga përvoja që kam, gjatë gjithë përpjekjet tona për liri, më është mbushur mendja se edhe për së vdekuri, trupi im, vetëm në këtë vend do të pushoj i qetë dhe gjejë rehatinë e njëmendët të amshimit”! Ndaj, pa marrë parasysh se si dhe ku e ka shkruar Zoti të vdes, prej dakikut kur do të jap shpirt, trupi im të sillet në këtë vend ku jemi, në shtëpinë e Salih Qarrit dhe të varroset në Has!

Pra, nga sot mbajeni mend burra të gjithë sa jeni këtu, për së gjalli - po u lë me gojë; "Amanet që trupi im të varroset në Has “!

Pasi, burrat i dhanë fjalën, që “të gjallë me shpirt” do ta plotësonin dëshirën e fundit të Heroit dhe çonin amanetin e tij në vend, në heshtjen që kishte kapluar Kullën, Bajram Curri do të nxirrte nga xhepi edhe një fotografi të veten, ofronte të zotit të shtëpisë, Salih Qarrit, dhe porosiste me kujdes:

*Salih merre këtë “**Testament**”! Veja mendjen “vëlla i dashtun” dhe ruaje mirë! se në këtë “Resëm” (fotografi) është shkrua amaneti im”!*

Ke vuajtur shumë, bashkë me familje, na ke prit e përcjell gjithmonë me nder! Shpresoj te Zoti, se do të vijë një ditë, kur mundit që keni ba me ne, t'ia shihni hairin, ju dhe krejt hasjanët si njerëz kaq besnik dhe bujarë që jeni.

Ndaj, këtë fotografi timen, të cilën po ta lë kujtim, ruaje me kujdes, se prapa saj, si të thash, është i shkruar *amaneti im*, që në rast se vritem në këtë luftë të cilën po nisim, apo kudo që ta ketë shkruar Zoti të vdes, ata që mbeten pas nesh, trupin tim ta sjellin këtu në Kullë të Qarrit dhe varrosin në Has!

Hyseni thotë, se sipas kujtimeve dhe tregimeve të përsëritura, shpesh herë nga babai i tij, në ato çaste nuk kishte shpëtuar kush pa lot, kurse amanetin e tij, të gjithë e kishin përjetuar si parandjenjën e afrimit të shpejt të vdekjes së Heroit.

Porosinë historike, lënë nga Bajram Curri për varrimin e tij në Has, e dëshmon edhe sekretari personal i tij, i cili në kujtimet e veta, shkruan qartë se, personi kryesor në mesin e atyre që pas vrasjes, e sollën Bajram Currin, nga Dragobia në Qarr të Hasit, ishte ai -Tahir Zajmi, ngase e kishte amanet prej vet Heroit, që të vepronte ashtu.

Madje, *Amaneti* i Plakut të Maleve, vërtetohet edhe në vargjet e këngës kushtuar Bajram Currit, nga rapsodët e Hasit, Isen Dida e Rrustem Çela, në të cilën, pa asnjë ekuivokë edhe ata shprehen:

E pat lanë me gojën e tij

Në Krumë të Hasit n 'dhe me shti!

(youtube Dida Çela Kovaçi - Bajram Curri (Official)-minuta 2.45.)

Fotografia me porosinë historike të Bajram Curri, sipas Hysen Qarrit, pas ardhjes së komunistëve në pushtet, do të merrej (nga Man Poga) dhe ekspozohet në Komitetin e Partisë, në Kukës, kurse Nënë Hala me rastin e kremtimit të përvjetorëve të Pavarësisë, do të ftohej edhe në Vlorë si Nënë Patriote, për kujdesin e treguar në çdo kohë ndaj Heroit të Kombit, Bajram Curri, dhe ushtarëve të tij, njëjtë si atëherë kur siç thonë rapsodët.

Pushkët e para paskan krisë

Në Krumë të Hasit luftë është nisë

Në krye me Plakun e Maleve, më 25 maj të vitit 1924, kryengritësit pasi çliruan Krumën do të viheshin në ndjekje të Muharrem Bajraktarit, ikjes së të cilit, nga rapsodët e lartcekur, iu thurën edhe vargje komike, si këto në vijim;

Me vrap qeni kush po ikë

Bajraktari me do zabit

Ndërsa, pas shkuarjes së Bajraktarit te miqtë e vet në Serbi, këngëtarët popullor shprehen;

Bajraktari ish kanë i zi

Për do pare po ik në Serbi

Trimat e Bajram Currit, pa humbur kohë, nga Kruma do të vazhdonin për në Lumë e Dibër, duke mos ndaluar deri në Tiranë, ku më 10 qershor të vitit 1924, do ta rrëzonin qeverinë e Zogut dhe sillnin atë të Fan Nolit në pushtet.

Ardhja e Nolit në Pushtet

Mospërfillja e Zogut ndaj çështjes së shqiptarëve të mbetur nën pushtim, keqtrajtimi dhe tëhuajësimi ekstrem i atyre që strehoheshin në Shqipëri, përndjekja e figurave më të ndritshme kombëtare, etj., detyroi Komitetin e Kosovës që përfundimisht ta konsideronte Ahmet Zogun tradhtar dhe pasues besnik të Esad Pashë Toptanit, i cili njëjtë si daja (E. Toptani) edhe Zogu mëtonte të arrinte kompromis me qeveritarët serbë në dëm të çështjes kombëtare.

Ndaj pjesëtarët e këtij komiteti me vetëdije dhe dëshirën për ndryshim qëndrimesh të qeveris së ardhshme ndaj Çështjes Kombëtare, ndihmuan ardhjen e Nolit në pushtet, ani pse edhe ai, Komitetin e Kosovës, e la jashtë qeverisë së tij, ashtu siç kërkonte prej saj, udhëheqja jugosllave.

Qeveria e Nolit u tregua aq e brishtë dhe e pa zonja, sa bëri që vendi të futej në kaos, rritej pasiguria dhe nëpërkëmbej gjithandej ligji, i cili pothuajse në asnjë sektor të shtetit, nuk respektohej as gjente zbatim të nevojshëm.

Madje krejt ajo që Noli bëri për Komitetin e Kosovës, ishte marrja e Bajram Currit si pjesë e delegacionit shqiptar, për paraqitjen e problemit të të drejtave të nëpërkëmbura të shqiptarëve nën pushtim, në shtatorin e vitit 1924, pranë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

Vendosja e Bajram Currit në Malësi

Qeveria e Nolit, do të qëndronte në pushtet deri më 24 dhjetor të vitit 1924, kur me ndihmën e mercenarëve të paguar shqiptar e serbo-rus, dhe qeverisë së Serbisë, do të vinte prapë në fuqi Ahmet Zogu për të qeverisur e mbretëruar edhe 15 vite të tjera Shqipërinë.

Por, me tu kthyer nga Lidhja e Kombeve, i dëshpëruar tej mase me gjendjen e pa shpresë dhe jo-stabilitetin e theksuar të qeverisë së Nolit, rrezikun e përhershëm të ndërhyrjes së forcave serbe dhe mundësinë e kthimit të Ahmet Zogut në çdo kohë me forcat mercenaro-reaksionare në Shqipëri, nga java e dytë e tetorit të vitit 1924, Bajram Curri do të vendosej përfundimisht në Malësi.

Heroi i zhgënjyer si asnjëherë më parë, do të ngjitej në vendlindjen e të parëve të vet, dhe vendosej në shtëpinë e Sali Manit, atëherë bajraktar i Krasniqes, prej nga, vazhdoi përpjekjet e dëshpëruara për organizimin e një lëvizjeje të re, kundër veprimeve antikombëtare të Cena beg Kryeziut dhe pushtetit të Ahmet Zogut, pas kthimit të tyre në pushtet.

Kthimi i Ahmet Zogut në Shqipëri

Ahmet Zogu dhe sejmënët e e tij, me të ikur në mbretërinë jugosllave, nuk kishin kërkuar vetëm strehim dhe shpëtimin e tyre nga Serbia, por edhe ndihmë ushtarake, për t'u rikthyer sërish në vend dhe rimarrë pushtetin me dhunë në Shqipëri.

Madje, ata kishin bindur plotësisht qeverinë serbe, se kryengritja e cila rrëzoi Ahmet Zogun, ishte organizuar nga “Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës”, nën udhëheqjen e Bajram Currit dhe Hasan Prishtinës, të cilët pareshtur u bënë thirrje dhe mbështesnin edhe shqiptarët nga viset e pushtuara për kryengritje kundër okupimit sllav.

Ndaj, vet Nikolla Pashiqi, do të lidhte një marrëveshje të veçantë me Ahmet Zogun, që ta ndihmonte financiarisht dhe ushtarakisht kthimin e tij dhe klikës që e rrethonte, në pushtet, si shërbëtor të dëshmuar dhe përbetuar shumë herë të Serbisë të cilët përfaqësonin me besnikëri interesat e saj në Shqipëri, me kusht që me të marr pushtetin, Zogu të mbyllte organizatën e “Komitetit Kombëtar të Kosovës” dhe të ndiqte kudo e pa asnjë “pardon” veprimtarët kombëtar.

Marrëveshja me kryeministrin serb Nikolla Pashiq, parashihte që pas kthimit të Zogut në pushtet, përveç shuarjes së “Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës” si dëmshpërblim, t'i epte mbretërisë Jugosllave, Shën Naumin në Juglindje dhe Luginën e Vermoshit në veri të Shqipërisë.

Ndaj nga 24 dhjetori i vitit 1924, me ndihmën e forcave jugosllave, mercenarëve rus e shqiptar dhe pajtimin ndërkombëtar, Ahmet Zogu do të kthehej në Shqipëri, i cili posa erdhi në pushtet, shpërndau me forcë Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, filloi një ndjekje të egër ndaj të gjithë kundërshtarëve të tij, si dhe nisi spastrimin e pamëshirshëm të patriotëve më të shquar shqiptarë, të cilët ende përpiqeshin e luftonin për çështjen kombëtare.

Ndjekjen e forcave kundërshtarë, Zogu e përqendroi kryesisht në veri, ku synonte kapjen e Bajram Currit dhe shpartallimi i mbështetësve të tij.

Sipas shkrimeve të Niman Ferizit, rreth 10 ditë pas rrëzimit të Qeverisë së Nolit, më 2 janar të vitit 1925, Bajram Curri, do të organizonte një kuvend me prijësit e Krasniqes, ku do të lidhnin besën ndërmjet veti, për rezistencë ndaj Qeverisë së Zogut.

Ndaj, 6 ditë më vonë, në agimin e hershëm të 8 janarit, forcat e udhëhequra nga Bajram Curri, në një ballafaqim të ashpër në të cilin do të binin 10 xhandar qeveritar dhe një luftëtar i tij, do të merrnin Tropojën, ndërsa të nesërmen më 9 janar 1925, do të niseshin për Bytyq dhe Krumë, qendrën kryesore në Has, ku ishte e vendosur edhe prefektura e Kosovës. (*Niman Ferizi, "Familja Curri" fq.37-38, Zara 1935.*)

Komandant i operacioneve ishte emëruar Cena beg Kryeziu, kurse forcave që ai udhëhiqte pa vonesë do tu vinin në ndihmë edhe shumë mercenar jugosllav, të cilët sipas shënimeve të Tahir Zajmit, tanimë ata kishin hyrë në Malësi dhe arritur deri në Valbonë.

Madje, me ardhjen në ndihmë edhe të Muharrem Bajraktarit komandant xhandarmërie, si dhe të vëllait të Ceno begut, Hasan bej Kryeziut, atëherë prefekt i Krumës dhe prefekturës së Kosovës, e cila në atë kohë përfshinte Hasin, Lumën dhe Malësinë e Gjakovës, me shërbëtorët e tyre, forcat zogiste kishin arritur që të pengonin shtrirjen e mëtejme të kryengritjes.

Atë kohë, përveç rrëzimit të kullave dhe djegies së shtëpive, nga Kadri Mehmeti, Ceno begu, sipas shkrimeve të Sejfi Vllamasit, nuk u mjaftua vetëm me vrasje dhe djegie, por ai vari edhe shumë njerëz pa gjyq. (*Sejfi Vllamasi "Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942" Tiranë 1995*)

Kah po shkon toger Kadria

Po djeg Kulla po rrëzon shtëpia

Kështu do ta kujtonin brutalitetin e toger Kadri Mehmetit, ndaj popullsisë civile dhe mbështetësve të Bajram Currit, asokohe, rapsodët Hashim Shala e Tahir Drenica, në minutën 7.12 sec. të këngës kushtuar Plakut të Maleve:

(www.youtube.com/watch?v=e5Z3eIIZEZJw)

Kasaphanat kundër bashkëkombësve, tradhtari i kombit, Cena beg Kryeziu, i kishte filluar qysh herët dhe pothuajse qysh me lindjen e shtetit shqiptar dhe menjëherë pas shpalljes së Shqipërisë shtetit i pavarur.

Sipas shënimeve të Tafil Buletinit, në tetorin e vitit 1914, ai kishte zgjedhur pikërisht ditën e Bajramit të vogël, për të kapur Bajram Curri në befasi, bashkë me malazezët, ditë kur njerëzit përkundër varfërisë së madhe dhe problemeve të shumta familjare, mundoheshin të krijonin sadopak atmosferë festive dhe nuk prisnin vrasje e gjakderdhje ndërshqiptare.

Por, me urdhër të Esat Pashë Toptanit, Ceno beg Kryeziu dhe gjenerali famëkeq malazez Radomir Veshoviq, me dy batalione ushtarësh serbo-malazez, pikërisht atë ditë, pa pritë e kujtuar, do të sulmonin në befasi Krumën, për kapjen e Bajram Curri, të cilin për shumë kohë ishin përpjekur ta zinin të gjallë malazezët.

Por, ai, duke mos e pritur aksion arrestimi mu atë ditë, mezi do të shpëtonte, duke kaluar në Va të Spasit, përtej Drinit, me ata pak bashkëluftëtar që kishte me vete.

Vendosja e Bajram Currit në Dragobi

Sipas shkrimeve të "biografit" dhe nipit të kryezinjve të Gjakovës, Mithat Begolli nga Peja, Ceno begu, tanimë gëzonte përkrahje të madhe edhe në Malësi, ndaj Ahmet Zogu do ta ngriste atë në gradën e kolonelit dhe emëronte komandant të Garnizonit në Shkodër, ndërsa pas pak kohësh, me kërkesën e qeverisë jugosllave, Zogu do ta emëronte Ceno begun edhe ministër të punëve të brendshme në Shqipëri, kurse të vëllain më të vogël, Hasan bej Kryeziun, prefekt të Krumës.

Më 11 Janar të vitit 1925, forcat e Ceno begut do të sulmonin Gashin, kurse më 12 janar të atij viti, do ta sulmonin Krasniqen, ku përveç tjerash, do të digjnin edhe shtëpinë e Bajraktarit Salih Mani, në të cilën deri atëherë, kishte qëndruar Bajram Curri.

Ndaj përkundër borës së madhe dhe të ftohtit të ashpër që mbretëronte atë dimër, Heroi me 100 bashkëluftëtarët e tij më besnik, detyrohet tu ngjitet sërish majave të bjeshkëve deri në lartësitë 2600 metërshe mbidetare, prej nga shumicën prej tyre, do ti kthente në shtëpi, shkaku i ngrirjes së trupit dhe bllokimit të gjymtyrëve, nga të ftohtit dhe acari. Sipas kujtimeve të Niman Ferizit, megjithëse Bajram Curri ishte ngrirë edhe vet në shpatull, duke parë se shumë trimave të tij, pa rroba e veshmbathje të mjaftueshme, u ishin marrë duar e këmbë nga të ftohtit e madh, do të kërkonte nga ta që të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Madje, edhe në gjendjen që ishte, ai do të gjente forcë që ti

përcillte ata me fjalët të zgjedhura miradie, falënderime të sinqerta dhe mirënjohje dashamirëse prej heroi, vet-flijues:

Burra ,Zoti e paska shkru që unë të vdesë mbi borën e këtyre maleve. Juve Perëndia u ndihmoftë se keni bërë gjithat që keni mundur për mu, ndaj mi bëni hallall mundin e vuajtjet dhe kthehuni në shtëpi pranë familjeve tuaja, se nuk dua t`u marrë në qafë edhe juve.

Me gjithë vështirësitë e shumta pas përmbysjes së Qeveris së Nolit në dhjetor të vitit 1924, kthimin e Ahmet Zogut në pushtet, përndjekjen e tij këmba-këmbës nga xhandarmëria dhe mercenarët si dhe të gjitha ngjarjeve që ndodhnin aq shpejt dhe rrëmbyeshëm atje, Bajram Curri, për asnjë moment nuk do të largohej nga Shqipëria.

Ai, edhe në moshën që ishte, sërish me armë në dorë, do t`u ngjitej maleve dhe kthehej luftës në Bjeshkët e Krasniqes.

Nga atje, heroi ynë do t`u bënte thirrje edhe një herë, kryengritësve në tokat e okupuara, që ata të vazhdonin përpjekjet e tyre edhe më tej, me të gjitha mjetet dhe mundësitë kundër dhunës, spastrimit etnik dhe gjenocidit të qeverisë pushtuese serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe trojet e tjera etnike nën pushtimin sllav.

Përpjekjet e Bajram Currit për organizimin e një kryengritje të re, ndryshimin e pushtetit në Shqipëri, çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera të pushtuara shqiptare, si dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë, nuk reshtën asnjëherë ,deri në momentet e fundit të jetës së tij patriotike. Ai e kishte kuptuar me kohë edhe nga e kaluara nëpër luftërat për liri, se vetëm bashkimi kombëtar do t`u mundësonte përfundimisht shqiptarëve, mbijetesën dhe një ardhmëri të sigurt për të gjithë kombin.

Derisa shumica e mbështetësve të tij do përshëndeteshin me lot e vaj dhe ktheheshin në vatrat e tyre, të cilat edhe ashtu, nuk ishin më të sigurta, nga kërcënimet e forcave zogiste, që burgosnin e terrorizonin njerëzit për më të voglin dyshim, dhe varnin e vrisnin pa asnjë gjyq, sa herë i tekej tradhtarit Cano beg Kryeziu, Sali Mani, Bajraktari i Krasniqes, sapo kishte strehuar familjarët në ato kohë të vështira dimri, do të kthehej përsëri tek Bajram Curri, siç i kishte dhënë “Besën” për të qëndruar deri në fund, në mbrojtje të tij.

Forcat e Cena begut dhe Kadri Mehmetit, duke përfituar nga tradhtia e njerëzve të shitur me të holla, përditë e më tepër i afroheshin vendqëndrimit të tij, por, megjithëse rrethimi i heroit sa vinte e ngushtohej, Plaku i Maleve kishte vendosur që të mos tërhiqej më tej.

Mbështetja me ushqime

Përkundër faktit se në ato kohë të vështira, shumë familje nga frika e represioneve zogiste, ishin distancuar dhe kishin “rrudhë” përkrahjen ndaj Heroit, Shtëpia e Qarrit nga Hasi me meshkuj e bashkëfamiljar të saj, edhe nën atë gjendje kërcënimi e rrezikshmërie, kur njerëzit shkonin me kokë, pasurinë e vet, bukën, stanet e bagëtinë, dhe çdo gjë që kishin, do ti venin në mbështetje të kryengritësve kombëtar me në krye Bajram Currin me shokë.

Sali Qarri me bashkëfamiljar, patën edhe një arsye më shumë ta donin dhe mbështesnin heroin, ndoshta pak më tepër se të tjerët, edhe për faktin se ata, Plakun e Maleve e kishin vëlla nga fisi, gjë që nga familje dhe njerëz të ndershëm, atëbotë vlerësohej shumë, ndaj sidomos nga viti 1922-1924, ajo me krejt çfarë mundi dhe diti, i shërbeu pa asnjë kursim, vetëm këtij burri.

Kështu që, edhe pas kalimit të mëvonshëm, deri te qëndrimi i fundit i Bajram Currin në Malësi, heroi jo rastësisht, kohë pas kohe, do të vendosej në malet e ashtuquajtura të “Dobërdolit” dhe strehohej në stanet e shtëpisë së Qarrit, e cila kishte hisen e saj atje.

Burrat e kësaj shtëpie, megjithëse ndëshkimet nga pushteti Zogist ishin bërë tmerrësisht të rënda, terrenit të thyer malor dhe kohës së ftohët të dimrit, edhe kur Heroi ndërronte vend dhe strehohej në vende tjera nëpër bjeshkë, ata herë duke shkuar kinse për të prerë dru, e herë duke dërguar bagëtinë andej gjoja për kullotje, furnizonin pareshtur deri në mundësinë e fundit, me bukë Bajram Currin dhe bashkëlufëtaret e tij.

Madje, jo vetëm shtëpia e Qarrit e cila bazuar në traditën fisnore, pasi që edhe vet kishte origjinën nga Kolgecaj i Malësisë dhe i takon fisit të Heroit, sipas kanunit shqiptar ndjente obligim ta mbante e mbështeste pa kursim Bajram Currin, por shumica e hasjanëve edhe nga Bytyqi e fiset të tjera, bashkë-jetonin, me shpirt e zemër, me të gjitha përjetimet e këtij Burri të Kombit.

Shembulli më i ndritshëm, siç shprehen edhe rapsodët popullorë për të, ishte flijimi i Hoxhë Zogut, i cili ashtu siç i kishte dhënë besën, Heroit, më parë pranoi të vdiste dhe varej në litar nga Cano beg Kryeziu, por jo ta tradhtonte Bajram Currin.

Cana Begu iu ngërmue

Bajram Currin me ma tregue

Se ne bëfsh Hoxhë mos mem tregue

*T`koft dhënë besa në konop të kam vnue
Kurse ai, siç e shpjegon edhe kënga, nga minuta 5.20, megjithëse
Cana Begu i kërkon Hoxh Zogut me i tregu vendqëndrimin e
Bajram Currit, ai jo vetëm se nuk pranon, por përkundër
kërcënimit me vdekje (varje në litar) do ti përgjigjej me trimëri të
pabesueshme, Cena beg kryeziut.*

*Cana beg, më paske ngushtue
S`ka tri dit që ka ndejt Begu me mue
Po hiq nuk muj per me të tregue
Se në Besë të zotit i kam premtue
Që për pa më gri e me më coptue
Bajram Currin s`kam me tradhtue*

Marash Krasniqi "Ai Hoxhë Zogu një hoxhë i ri"

https://www.youtube.com/watch?v=-_0TNDI9yAo

Plaku i Maleve, kishte kaluar shumë kohë në Has: Madje atje ai ishte familjarizuar aq shumë, pothuajse me të gjithë, sa që te secili, rrinte si në shtëpi të vet, madje edhe gjatë kohës së pushtimit turk, kur babai i Ceno begut, Riza beg Kryeziu, i prishte atij kullat dhe kërcënonte që të mos guxonte të shkonte në shtëpi të veta në Gjakovë, se për ndryshe;

Te qarti Kulla e te rrezoj Shpi

Të qes kaskin e të del ma zi

Mue me thon beg -Kryezi

Ndaj, ashtu siç e kishin mbajt e mbështetur gjithmonë me sa mundësi kishin, edhe pas djegies së Shtëpisë së Salih Mani, familja e Salih Qarrit nga Hasi, sërish bënte të gjitha përpjekjet për mbështetjen e mëtejme të Bajram Currit, por edhe të familjes së Salih Mani.

Stanet e saj që kishte në malet e "Dobërdolit" në Malësi, natë e ditë tymonin, ku gatuhej pareshtur për të dhe bashkëlufëtaret e Heroit.

Ai, jo rrallë, i zhgënjyer me qëndrimet e disa njerëzve nga të cilët nuk e kishte pritur, siç na kujtojnë edhe rapsodët; Tahir Drenica e Hashim Shala, në biseda me bashkëlufëtaret, Bajram Curri do të shprehje i dëshpëruar:

Për Shqipëri ilet po më jetë

E për te boll kam hjek,

Po, s`un e qita, në selamet

Nënë Hala do të gatuante pareshtur, për Heroin dhe ushtarët e tij, ngase si na dëshmojnë këngët e kohës, për Shqipëri, ai do të qëndronte nëpër stane edhe nga tre muaj, teshat pa i hjek:

Nëpër stane, nëpër bjeshkë

Nga tre muaj, teshat pa i hjek

Por, fatkeqësisht përkundër të gjitha vuajtjeve të tij, kohët kishin ndryshuar dhe Cena begu, tanimë gjeti shumë mbështetës në Malësi, disa prej të cilëve i shërbenin me dëshirë e disa ai i paguante edhe me para.

Ndaj një ditë prej ditësh, dy agjent të Zogut, papritur do të ngjiteshin edhe në stanin e shtëpisë së Qarrit dhe merrnin për disa orë rresht, në pyetje Nën Halën, pse gatuante aq herët në mëngjes dhe pothuajse çdo herë nga “dy-tre pite”, kur aty rrinin pak njerëz të familjes.

Arsyetimet këmbëngulëse se shtëpia e burrit të saj, ishte familje e madhe, dhe shumica e bulmetit gjendej në stan, ndaj dhe duhej gatuar për të gjithë sa më herët në mënyrë që ata të shkonin me kohë në punë, kishte “detyruar” ata të shkonin, përkohësisht.

Por, nga dita e kontrollimit të tyre e tutje, ajo do të mbyllte mirë dhe me çfarë kishte dyer e dritare, duke hapur një vatër zjarri në mes të stanit dhe gatuar vetëm natën, për Bajram Currin me shokë, ndërsa ditën për familje.

Bukën, Bajram Currin do t’ia dërgonin rregullisht Zekë Qarri dhe i vëllai Neziri, duke u ndërruar me njëri tjetrin, herë duke nisur bagëtinë (dhitë) andej kinse për kullotje më në lartësi të maleve, e herë duke shkuar gjoja për të sjellë dru për ngrohje, gatim e ndezje zjarri në stan. Ato ditë të vështira, edhe pjesëtarët e familjes së Sali Manit, mbetur pa shtëpi e katandi nga ekspeditat e egra të xhandarëve të Ceno begut, Kadri Mehmetit dhe Muharrem Bajraktarit, do të afroheshin shpesh fshehurazi deri pranë stanit, që të merrnin ndonjë grusht miell e qumësht, e kur qëllonte edhe ndopak qaj e sheqer ,për ti ushqyer kalamajtë e mbetur pa strehë.

Një ditë, thuhet se Bajram Curri ,i cili kishte kaluar shumë kohë në Has, njihte personalisht gati të gjithë hasjanët dhe dallonte pothuajse shijen e bukës së çdo familje atje, do ti thoshte bajraktarit S. Mani; “Salih kjo bukë, është e shtëpisë së Qarrit!”

Po, Bajram Beg, ishte përgjigjur ai!

Hasjanët, do të vazhdonte Bajram Curri, më pritën çdo herë bujarisht, më mbështetën gjithmonë pa hile, më qëndruan kurdoherë pranë, nuk

më harruan asnjëherë dhe ndihmuan në çfarëdo gjendje që u ndodha-besnikërisht...

Në Has, shënova fitoret më të ndritshme dhe kurorëzova sukseset më të pa imagjinueshme, duke filluar që me betejën në Qafë të Prushit, për çlirimin e trojeve shqiptare nga Perandoria turke, Kryengritjen e Krumës dhe përmbysjen e Zogut më 10 qershor të vitit 1924, madje edhe në gjendjen që sot ndodhem, ata ende nuk më harrojnë dhe kujdesen kaq shumë për mua...

Pra vëlla i dashtun, siç e kamë thënë, trupi im edhe për së vdekuri, mund të gjejë qetësi vetëm në mesin e atyre njerëzve, ndaj, të bëjë rixha (të lutem), sido që të vije puna e kurdo që të jetë shkruar të vdes, mos harroni **amanetin tim**, dhe cilido që të mbetet pas nesh, dua të më varrosin vetëm në Has!

Edhe pse kjo nuk ishte hera e parë, që Bajram Curri linte këtë porosi për së gjalli, Sali Mani, nga droja se edhe ai mund të vritej në përpjekje me forcat e Cena begut, do t'ua përsëriste shpesh bashkë-familjarëve fjalët e Heroit, sa herë pati mundësi ti takonte ata, në ato ditë të vështira, që ta mbanin mend dhe vepronin siç e kishte lënë vet heroit amanet me gojën e tij.

Rrethimi dhe vrasja e Bajram Currit

Bajram Currit, derisa qëndronte në male, sa më tepër i afroreshin ata që kërkonin kokën e tij, gjithnjë e më shpesh i kujtohej se sa me shpirt kishte luftuar për çlirimin e Malësisë nga serbët e malazezët, sa shumë mund e përpjekje kishte bërë ai, për pajtimin e fiseve të Gashit dhe Krasniqes, të cilat për një kohë bukur të gjatë, kishin qëndruar në hasmëri ndërmjet veti, se sa shumë besim, ai kishte pasur në ato fise, kurse ato tani që të dyja ishin bërë bashkë dhe vënë në ndjekje të Heroit!

Madje, mu atëherë, kur pranvera sapo kishte filluar me nxjerrjen e sythave të para, nëpër gjethe dhe lajmëronte ardhjen e saj të shpejtë, nga mercenarët e Cena beg Kryeziut, dhe njerëzve të shitur atje, rrethimit të Bajram Currit, po i vinte fundi.

Dhe pikërisht më 29 Mars, të vitit 1925, posa kishte zbardhur mëngjesi, fatkeqësisht në derë të shpellës së Dragobisë, pa prituri do të paraqitej Kadri Mehmeti, kushëri për nga fisi i Bajram Currit dhe nip i fisit të Gashit, si përfaqësues i dy fiseve kryesore të Malësisë, me dhjetëra xhandar edhe ata pothuajse që të gjithë nga Krasniqja dhe

Gashi, të mashtruar se gjoja shkonin ta merrnin në "besë" e me mirëkuptim Bajram Currin dhe dërgonin vullnetarisht në Tiranë.

Por me të arritur, aty, Kadri Mehmeti në vend të shtrirjes së dorës vëllazërore dhe jetësimit të "Besës" së premtuar, ai do të thërriste me tërbim; "Dorëzohuni"! se jeni të rrethuar...., akt i ulët e cinik ky, i cili do të qonte në nisjen e luftës vëllavrasëse, mes Davidit dhe Goliatit për jetë a vdekje.

Ndaj, sipas këngëtarit popullor, para se të vdiste, Heroit nuk do ti durohej më, pa u drejtuar këtyre fiseve nëmën e fundit, kujtuar tradhtinë që po i bënin dhe merrnin fytyrën në çastet më të vështira, ndaj:

I qon fjalë parisë së Gashit

Mujë Hoxhës e Rrustem Bajramit

Juve u plaqin sytë e ballit

qysh ja shitët vatanin djalit

Ja morët fytyrën këtij plakut

Bajram Curri, për tu dalë në ndihmë banorëve të Krasniqes dhe gjithë Malësisë, thuhet se ai kishte blerë edhe një copë vend me parat e tij dhe ndërtuar atyre edhe një Mulli për bluarjen e drithit, që ata të mos mundoheshin duke bartur larg, thasët e drithit mbi shpinë, ndaj edhe në çastet e fundit të jetës së tij, me të dëgjuar fjalët e Sali Manit se një rrem komit janë hy grykës përpjetë dhe nisë drejt shpellës ku ai strehohej, duke mos besuar se vërtetë edhe vet njerëzit e fisit të tij, ishin në gjendje t'ia kthenin armët Bajram Currit, Heroi do të shprehej i habitur:

Hajt Sali, çka po thue

Nuk më pret Krasniqja mue!

Por, shpirti krenar i Bajram Currit, i cili përherë mbeti kryengritës deri ditën që vdiq, me të kuptuar realitetin e hidhur dhe dëgjuar thirrjen e tradhtarit Kadri Mehmeti për dorëzim, sipas këngëtarit popullor, Heroi atij do t'i përgjigjej burrisht dhe me përbuzje të trishtë:

O Kadri ore Budallë

Nuk dorëzohet Begu (Burri) i gjallë

S`un m`ka lidhë Krajli as Mbreti,

Jo po më lidhë Kadri Mehmeti

Nxuer alltinë e i ka ra veti....

Fatkeqësisht, kështu, në këtë mënyrë kaq tragjike dhe fare të palavdishme për shqiptarët, do të shuhej jeta edhe e Një Heroi, jeta e Një Burri të madh e të papërsëritshëm kombëtar.

Sjellja nga Dragobia dhe varrimi i Bajram Currit, në Has

Sado që në disa shkrime ende thuhet se kinse Zogu kishte vendosur që të mos e vriste Heroin e Kombit, në moshën e shtyrë në të cilën ai ishte ,duke ditur pabesitë e Ahmet Zogut, lidhjet e tij familjare me Cena beg Kryeziun, si dhe marrëveshjet që ata dy kishin me qeverinë e Serbisë, Bajram Curri nuk mund t'i besonte më asnjërit, nga ta, ndaj edhe nuk do ta pranonte çarmatosjen e aq më pak dorëzimin që ishte “term” i huaj për të dhe akt që nuk e njohu kurrë në jetën e tij.

Madje, ndikimet e Bajram Currit, edhe në Kosovë dhe trevat tjera të banuara me shqiptar nën pushtimin sllav, ishin aq të mëdha, sa që edhe para rrëzimit të Ahmet Zogut, qysh në vitin 1923, Qeveria jugosllave do të dërgonte me një qese plotë para, agjentin e saj kolonel Juroviq, të taktonte Bajram Currin në Shqipëri, dhe ofronte atij mundësin e kthimit në Kosovë me kusht që ai të bëhej lojal ndaj pushtuesve serb, ose edhe të emigronte jashtë vendit, me ndihmën e tyre.

Por, Bajram Curri, si atdhetar i përbetuar dhe prijës e luftëtar i pakorruptuar që ishte, i cili si rrallë kush tjetër, ai mbi të gjitha e donte Atdheun dhe çlirimin e popullit të vet, do ti përgjigjej shkurt dhe prerë të deleguarit sllav: Kosova është vendlindja ime, dhe aty nuk mund ta ftojnë mysafirët(e paftuar), kundër të cilëve jam i vendosur të luftoj deri në vdekje. Ndaj, në Kosovë, unë ose do të kthehem fitimtar, ose i shtrirë në tabutin (**shtratin**) e **dëshmorit** të rënë për lirinë e saj, ndryshe jo!

Nga dhembja për një luftëtar trim e besnik si Bajram Curri, sipas prof. dr. Isuf Bajraktarit, në emisionin TARGET të RTK-s, më 15.08.2013, pas rimarrjes së pushtetit nga Ahmet Zogu, Hasan Prishtina do të udhëtonte edhe vet në Bujan, ku do ta takonte personalisht Bajram Currin, dhe luste që të largohej nga Shqipëria, pasi që asnjëri nga ta, nuk i donin vëllavrasjet dhe luftën ndërshqiptare, e në anën tjetër edhe mundësit e mbijetimi të Heroit në moshën që ai ishte dhe kushtet klimatike e politike të cilat mbretëronin në vend asokohe ishte i pamundur.

Por, Bajram Curri i betuar që të mos largohet nga Shqipëria, do të pajtohet që Hasan Prishtina të dilte jashtë vendit dhe bënte gjithçka mundëj dhe arrinte nëpër kancelarit evropiane, për tu ardhë në ndihmë shqiptarëve nën pushtim, kurse Plaku i Maleve vet, u kishte dhënë fjalën mbështetësve të tij, dhe betuar para tyre, se për së gjalli nuk do të largohet nga Atdheu, madje edhe pas vdekjes, eshtrat e tij, do të pushonin vetëm në Shqipëri.

Dhe, pas mase 30 vitesh lufte e përpjekjesh titanike kundër Perandorisë osmane, rreth 12-13 viteve luftimi kundër serbo-malazezve, dy-tre vitesh internimi austro-hungarez dhe gjithë atyre vuajtjeve e mundimeve të mëdha e të papërshkrueshme për shtetndërtim dhe mbrojtje të asaj pak Shqipërie, që u kishte ngelur shqiptarëve për shtet kombëtar, tanimë, të parët që tradhtonin Plakun e Maleve, ishin bijtë dhe vëllezërit e fisit të vet, ishin bashkëvendësit e tij dhe të trevës prej nga edhe vet të parët e Heroit kishin prejardhjen.

Madje, si për çudi, pothuajse me shumicën e atyre njerëzve, të cilët tanimë e ndiqnin për ta vrarë, Bajram Curri, vite të tëra kishte luftuar bashkë me ta, për çlirimin e Malësisë dhe trojeve tjera kombëtare si dhe ruajtjen e Shqipërisë Etnike.

Ndaj, fatkeqësisht, vdekja e tij nuk do të vononte, dhe përkundër atdhetarisë së pafund të heroit, tradhtari i kombit dhe bashkëpunëtori ngushtë i Serbisë me origjinë nga Gjakova, Cano beg Kryeziu, i kishte rënë në gjurmë dhe vetëm priste momentin ta likuidonte.

Ai nuk e ndiqte këtë burrë të papërsëritshëm vetëm për zhvillimet më të reja, por edhe për hesape të vjetra. Cano beg Kryeziut nuk i interesonte çështja kombëtare, ndaj që me kohë ishte *distancuar nga ajo* dhe deklaruar hapur kundër kombit, që i takonte *duke ndjekur e luftuar* atdhetarët më të devotshëm, sa herë i jepej mundësia.

Madje ai tanimë, shfrytëzonte edhe pozitën shtetërore të mundësuar nga ndërhyrjet e Nikolla Pashiqit dhe donte gjithsesi të hakmerrej sa më rëndë ndaj Bajram Currit edhe për hatër të Serbisë, të cilës i ishte betuar për besnikëri deri në vdekje.

Kështu, ai personalisht edhe kishte urdhëruar komandantin e xhandarmërisë Muharrem Bajraktarin nga Luma, që njësoj si Cano beg Kryeziu, edhe ai ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Serbisë, si dhe tradhtarin Kadri Mehmeti, nëntoger i xhandarmërisë nga fisi i Krasniqes dhe nip i parisë së Gashit, si Mujë Hoxhës e Rustem

Bajramit të Malësisë, që me çdo kusht dhe gjallë a vdekur, ta kapnin Bajram Currin atje ku ishte.

Megjithatë, Heroi, duke mos dashur të linte përshtypjen se ai u vra nga Cano begu, në mënyrë që armiqësitë me kryezinjtë e Gjakovës të mos vazhdonin edhe më tej, sipas historianit Kastriot Dervishi, “ekziston fotografia” e tij në të cilën shihet se, para vetëvrasjes, heroit me qëllim ka hequr xhamadanin, që të mos i përlyhet me gjak, si dëshmi se ai nuk ishte i vrarë, nga Cano Beg Kryeziu, me familjen e të cilit që nga viti 1900 kishin vazhduar konfliktet.

Ndaj, me këtë gjest burror Plaku i Maleve, donte të mbyllte njëherë e përgjithmonë edhe gjaqet në mes dy familjeve të hasmuara ndërmjet veti, për aq vite.

Por, me gjithë qëllimin e mirë të Heroit për mbylljen e armiqësive me Kryezinjtë, dhe “dëshmive” gjoja se kishte edhe urdhër që të “mos” vritej Bajram Curri, tradhtari i kombit, i vendosur që t’i shkonte çmendurisë së tij vrasare deri në fund, sipas gazetës “La Feeration Balkanique” të datës 30 prill 1925, jo vetëm burgosi por Ceno beg Kryeziu, vrau edhe nipin e heroit, Asllan Currin bashkë me dy shokë, gjatë dërgimit të tyre nga Kruma në Shkodër ,me arsyetimin, kinse ata kishin tentuar të iknin.

Varrosja e Bajram Currit në Has pati marrëdhënie të veçanta, jo vetëm ndërnjerëzore, por edhe të një atmosfere familjare dhe vëllazërore, ndaj mu.

Miqësia e përzemërt dhe sinqeriteti i pakusht e i pa-hile i hasjanëve që nga kontaktet e para e deri në fund të jetës së bujshme të burrit më emblematic të kombit i cili me bashkëluftëtarë, kaloi shumë vite në trevën e tyre, ku pritej e përcillej “si në shtëpi të vet“, dashamirësia e madhe dhe sinqeriteti i pafund i atyre njerëzve, e bindën plotësisht Bajram Currin që të linte për së gjalli amanetin e tij historik dhe shprehte dëshirën për varrosje në Has.

Ndaj, pas shuarjes tragjike të Heroit, më 29 mars të vitit 1925, përkundër vrasjes në Dragobi të Malësisë, sipas porosisë së lënë me gojë, Bajram Currin, nga Dragobia do ta sillnin të ngarkuar mbi një Saj të ndërtuar nga drunjë mali dhe tërhequr me kali nga Bjeshkët e Malësisë, duke e vendosur para dyerve të Sali Qarrit, të cilin vet Kadri Mehmeti do ta provokonte me cinizëm, për të parë nëse ai guxonte ta merrte kufomën e heroit;

eja tani ta shohim burrërinë tënde, ja ku e ke, merre e jepi bukë, për së vdekuri, Bajram Currit, o Sali Qarri!”

Sipas dëshmimeve të Hysenit dhe pleqve të kohës, Sali Qarri i dëshpëruar, me ta parë trupin e pajetë të Heroit, shtrirë mbi Sajin, me të cilin e kishin tërhequr, prej lartësive të Dragobisë, nga dhembja do të hiqte plisin e bardhë, që e mbante vetë dhe vente Bajram Currit mbi kokë.



Bajram Curri i vrarë, www.forumishqiptar.com

Kadri Mehmeti, i tërbuar nga gjesti burrëror i Salih Qarrit, do të urdhëronte xhandarët që t’ia digjnin kullën dhe prisnin e dëmtonin, në numër sa më të madh bagëtinë. Por, derisa një pjesë e xhandarëve të Kadri Mehmetit kishin therur deshët më të mirë të tubës, që shtëpia e Qarrit, asokohe në mesin e 300 krerëve dele kishte, kurse pjesa tjetër e tyre, kishin mbushur kullën me sanë (bar të terur) kashtë e dru të thata dhe përgatiteshin për t’ia vënë flakën, një krismë pushke, nga Qafa e Prushit, do t’ua priste në gjysmë turrin e tyre bizar.

Njëri nga xhandarët, që bënte roje në Bokë, mal aty afër, do të vinte me vrap, për t’i dhënë lajmin e frikshëm Kadri Mehmetit, se disa burra vinin nga Malësia, kurse një grup luftëtarësh nga Kosova, sapo kishin kaluar kufirin në Qafë të Prushit dhe po i afroreshin Qarrit. Ndaj Kadri Mehmeti, në panik e sipër, i alarmuar nga tmëri se ata nuk kërkonin asgjë më pak se vet kokën e tij tradhtare, kishte urdhëruar që të mblidhnin me vrap deshët e theruar dhe të iknin sa më shpejt për në Krumë.

Pjesa e bashibozukëve që kishte arritur ti therte katër deshët e parë, ngarkojnë ata mbi shpinën e tyre dhe marrin me vete bagëtinë e dëmtuar, duke kulluar gjak nga shkonin, për ti ngrënë të katër deshët e pa fat, në një vend më të sigurt.

Kurse, Sali Qarri me bashkëfamiljar, do ta merrnin trupin e pajetë të Bajram Currit, fushin në shtëpi dhe lanin e pastronin sipas traditës,

vishnin në kostum të ri e plis të bardhë, venin në anë të djathtë **cigarllëkun e qelibartë** dhe një kuti sermi mbushur me duhan Shkodre, duke e vajtuar si pjesëtar të familjes.

Në kullën e Qarrit, Heroit, do t'ia bënin nderimet e veta edhe burrat e Krasniqes dhe luftëtarët nga Kosova, ku do të qëndronin deri në përfundimin e riteve të kohës nga personat fetar, dhe varrosjen e trupit të tij.



Pamje nga varrimi i Bajram Currit, foto e huazuar nga www.forumishqiptar.com.

Edhe sot e kësaj dite, ende flitet se fillimisht, trupi i Bajram Currit, u varros në pronat e familjes së Salih Qarrit në Has, derisa organet shtetërore, caktuan vendin dhe përgatitën ceremoninë mortore, **ngase komandanti i xhandarmërisë dhe udhëheqësit e prefekturës së kohës, nuk kishin lejuar që Bajram Curri të varrosej menjëherë në Krumë.**

Por megjithatë, ditën e varrimit në Krumë, për habinë e të gjithë atyre që panë dhe dëgjuan, një fjalim të "zjarrtë" do ta mbante edhe prefekti Hasan Kryeziu, vëllai i "famshëm" i Cena begut, i cili vdekjen tragjike të Heroit, pa fije turpi, do ta cilësonte si një "aksident të rëndë", dhimbje të madhe dhe ditë të zezë për shqiptarët, ani pse vet ai me të vëllain Cena begun e Gjakovës, Muharrem Bajraktarin e Lumës, Kadri Mehmetin e Krasniqes dhe bashkëpunëtorë të tjerë, të njohur që nga fillimi si shërbëtor të përbetuar të Serbisë, kishin organizuar, urdhëruar dhe realizuar vrasjen e Heroit, duke e prerë në besë Plakun e Maleve!

Madje, me të përfunduar varrimi i Bajram Currit në Krumë, Muharrem Bajraktari, do ta veçonte nga turma dhe fyente me fjalët më të rënda Sali Qarrit, vetëm pse ai paska guxuar, që një "tradhtar" të qeverisë dhe armik të Zogut, si Bajram Curri, pa u konsultuar me

komandantin e xhandarmërisë së Krumës, ta lante e pastronte ,t'i vinte plisin e bardhë mbi kokë dhe vishte atë në rrobat më të shtrenjta familjare, madje edhe varroste në tokën e tij Heroin! duke i`a përsëritur disa herë me cinizëm dhe kërcënim, se si për çdo gjë në atë trevë, së pari duhej të pyetej komandanti i xhandarmërisë M. Bajraktari, pa fjalën e të cilit, asnjë veprim nuk “guxonte” të ndodhte. “E sheh këtë uniformë dhe gradat e mia”? Unë jam zot i Lumës e Hasit dhe gjithë prefekturës së Krumës!. Vetëm me lejen time mund të bëhet diçka në këtë trevë, do t`ia përsëriste disa herë me kërcënim bajraktari. Sot nuk pyet njeri, do të vazhdonte ai; kush është Qarri ,por kush është Muharrem Bajraktari... Pra, ta kesh me dije, se ke gabuar rëndë që e ke futë edhe për së vdekuri “tradhtarin” Bajram Curri në shtëpi, kjo do të kushtoi shumë, ty dhe familjes tënde!”

Sali Qarri ,i mërzhitur tej mase për vdekjen e Bajram Currit, të cilin pas varrosjes në Krumë i dukej sikur edhe për sëvdekuri ,ia kishin grabit me forcë nga duart Heroin, dhe i fyer nga fjalët e pamatura të bajraktarit, do t`i përgjigjej shkurt e shqip dhe pa menduar gjatë: “Shiko, zotni, Bajram Begu, nuk ishte tradhtar por njeri i popullit dhe shqiptar i vërtetë! Ai ishte burrë i respektuam i këtij vendi dhe luftëtar i nderum i Kombit!... Kurse sa më takon mua dhe paraardhësve të mi, edhe ne gjysh e stërgjysh, ishim e mbetëm vetëm shqiptarë, dhe asnjëherë nuk e ndërruam plisin tonë të bardhë me rroba të huaja.

Ndërsa ti, sa ishte Turqia, mbajte fesën turke; erdhën serbët, veshe uniformën e shkjaut, sot e mbanë atë të Zogut, e, po ndërruan kohët, kush e di se çfarë rrobe do mbash nesër! Ndaj mos fol asgjë të keqe për Bajram Currin sepse ai ishte një shqiptar i vërtetë që gjithmonë luftoi për vendin dhe Kombin e tij.

Ti, siç e ke vrarë këtë burrë, mund të më vrasësh edhe mua, por, mbaje mend mirë dhe mos harro kurrë, se një prapanicë që ulet në shumë kunja, ajo ,patjetër do të shqyhet dikund!”

I biri i Salih Qarrit, Hyseni edhe sot tregon se si Muharrem Bajraktari, kishte nxjerrë pistoletën nga brezi kundër babait të tij, por, duke e parë se masa e elektrizuar kishte hetuar se diçka po ndodhte dhe ishte nisur drejt tyre, nga frika e shpërthimit të ndonjë rrëmujë, krye-xhandari i trembur, do të largohej në drejtim të kundërt, duke e fshehur armën dhe ikur me të shpejtë, nga turma.

Për çudi, pa kaluar shumë kohë, i njëjti bajraktar, pas ngopjes me grada xhandareske, duke e menduar veten tanimë , të denjë për të

udhëhequr edhe me shtetin, sipas porosis së qeverisë serbe, e cila ishte ndarë e pa kënaqur me mos përmbushjen e të gjitha premtimeve nga Zogu, nuk do të ngurronte që të prishej edhe me shefin e tij. Kështu që më 1934, Muharrem Bajraktari, së pari do të kalonte në Jugosllavi, ku nën kujdesin e qeverisë serbe, do të instruktohej, armatosej e mobilizohej, siç veprohej me të gjithë renegatët shqiptar, dhe pa vonuar që në fillim janarin e vitit 1935, i shoqëruar me mijëra mercenar të mobilizuar nga Jugosllavia, do të nisej në kryengritje, tani për rrëzimin e Zogut dhe marrjen e pushtetit në Shqipëri.

Megjithatë bajraktari i sertë, brenda pak ditësh do ta humbte betejën e sponsorizuar nga Serbia, dhe pas dështimit të radhës, më 8 janar të atij viti, “si pa gjë të keqe” ai sërish do të kthehej në Serbi, në strofllin e vjetër, të cilin qeveria serbe e kohës e kishte krijuar enkas për bashkëpunëtorët shqipfolës dhe zbukuruar me kujdes të përsosur agjenturor, për shërbëtorët e saj më besnik, nga të gjitha trevat shqiptare.

Por, përkundër të gjithave, mjerisht, vetëm tek shqiptarët, ende nuk ka kufi të përcaktuar ligjor dhe etik, si dhe kritere plotësisht të qarta ndërmjet veprimtarisë tradhtare dhe asaj patriotike. Kufij që do të shprehnin në mënyrë të prerë dhe sqaronin tërësisht emrat e nderuar të kombit të cilët luftuan për vend e atdhe dhe atyre që u hodhën kundër tij.

Madje, në përpjekje për ndreqje dhe zbukurim jetëshkrimesh të dyshimta, fatkeqësisht edhe sot ka raste kur fare nuk hezitohet, të shkohet aq larg me njëanshmëri, sa që në disa nga shënimet “biografike” si ato mbi Muharrem Bajraktarin përfshi shkrimin biografik për të në “Vikipedia”, një njeri si ai, cilësohet edhe vigan e “nacionalist”...

Dhe si arsye, përdoret hiq më pak se vet eliminimi i Heroit Bajram Curri , nga ana e tij, më 1925.

Por, le të kalojmë edhe një herë te qëndrimet e Ahmet Zogu, i cili po ashtu si shokët e tij hakmarrës, përkundër rivaliteteve me vartësit e vet dhe luftërave të brendshme që ata zhvillonin pareshtur për pushtet, edhe ai mbështetjen e pakursyer të hasjanëve ndaj Bajram Currit, kurrë nuk do t`ia falte Hasit.

Ndaj, pas varrosjes së Heroit në Krumë, nuk do të vononte shumë dhe që në muajin gusht të vitit 1925, qendrën e prefekturës së atëhershme të Kosovës në përbërjen e së cilës ishte Hasi, Luma dhe Malësia e

Gjakovës, nga Kruma, ku ishte vendosur që nga fillimi, Zogu do ta zhvendoste në Kukës, ani pse sipas të dhënave publike, atëbotë Kukësi ishte shumë i vogël, me vetëm 28 shtëpi dhe 186 banorë. (*Wikipedia*)

Përjetimet e përsëritura, të njëjta apo të ngjashme me ato të familjes së Sali Qarrit, fatkeqësisht dëshmojnë se edhe ndryshimi i sistemeve në vend, pothuajse vetëm sa trashëgoi apo edhe vijoi më tej, por gati asnjëherë, nuk shoi xhelozitë e sëmura ndër-fqinjësore dhe vrasjet e padrejtësitë tipike ndërshqiptare.

Madje me gjithë mbështetjen dhe nderimin e pafund, që kjo familje bujare, në të gjitha kohët tregoi ndaj figurave më të shquara kombëtare, duke filluar nga Bajram Curri, Hasan Prishtina, Isa Buletini, Azem Bejta, Shote Galica, Zeqir Halili, Sadik Rama e shumë atdhetarë të tjerë të kombit, për të cilët dera e Shtëpisë së Qarrit ishte gjithmonë e hapur, pa përjashtuar edhe ndihmën e pakursyer, gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhënë brigadave partizane, atë siç thotë fjala popullore, fatkeqësisht “do ta vriste buka e vet”, dhe nuk do kursehej nga tragjeditë e qëllimshme njerëzore, përshtatur e përmbarruar nga fqinj e bukëpërmbysësh të sofrës së saj.

Menjëherë pas lufte ,njerëz të fshatrave përreth, të cilët qindra herë kishin ngrënë bukën dhe shijuar mikpritjen e bujarinë e kësaj shtëpie fisnike, të njëjtit jo vetëm se “do ta përmbysnin kupën” sa herë u epej mundësia, por me të ardhur në pushtet, nuk do të ngurronin as ta mbështillnin në zi, këtë familje atdhetare, duke nxitur e organizuar burgosje, vrasje e internime dhe veprimet më shkatërruese të mundshme ndaj pjesëtarëve të saj, faj e pa faj.

Kështu si shpërblim për bamirësit e pareshtura, do të shuheshin Dash Ahmet Qarri, duke vdekur në burgun e Shkodrës.

Kurse, Selim Imer Qarri, së pari do të lidhej, rrihej e shkallmohej dhe sillej në atë gjendje të rëndë, para dyerve të familjes së Salih Qarrit. Aty, me cinizëm do të thirrej i zoti i shtëpisë që ti fuste në konak dhe t’u shërbente atyre edhe me kafe, në momentet më të rënda e të papërshkrueshme, para se këtë pjesëtar të familjes së tij, duarlidhur ta qonin në vdekje-pushkatim.

Për herë të parë, pas aq vitesh të kaluara, Sali Qarri, nuk kishte mundur ti thoshte dikujt, urdhëro brenda. Për herë të parë në jetë ai ishte gjendur aq ngushtë, sa që të mos mund tu vinte në ndihmë as pjesëtarëve të familjes së vet. Për herë të parë ai përjetonte një rast si ky, kur një mashkull i shtëpisë së tij, mbahej i ngujuar duarsh e

këmbësh, nga një ish mysafir i shpeshtë dhe i njohur mirë për të dhe familjen, para dyerve të oborrit të vet, dhe ai nuk kishte mundësi të përballej me këtë gjendje!

I zoti i shtëpisë nuk kishte forcë të dilte e ta shihte në sy as ekzekutorin të cilin kushedi sa herë e kishte prit e përcjellë me dashamirësi e nderim në konak , njëjtë si djemtë dhe nipat e vet. Ai nuk mundi të dilte e ta takonte Selimin e lidhur këmbë e duar, të cilin nuk po e vriste Enver Hoxha siç ishin mësuar ata ta përdornin këtë “pako” të gatshme “shfajësuese” por jo tërësisht bindëse-arsyetimi, fqinjët me të cilët kishte ndarë bukën dhe rritur trupin bashkë me ta, por që tani ishin bërë smirëzi dhe hakmarrës, pa ditur as vet, se pse vepronin ashtu.

Shpirt - thyer e zemër-plasur, i pa forcë e pa mundësi veprimi, siç ndjehej ai në ato momente, do të zhgrehej në vaj, pa mundur të dilte jashtë, edhe për faktin se nga dritaret e kullës kishte vërejtur sesi gratë dhe fëmijët e frikësuar, si asnjëherë në jetën e tyre, fshehur pas gardhit dhe qosheve të shtëpisë shihnin me lot në sy, nga afër Selimin e lidhur dhe të shkallmuar nga rrahjet e keqtrajtimit.

Torturë më të rëndë për Salihun dhe familjen nuk kishte, sa që njëmijë herë më tepër ia dëshironte vetes vdekjen, se sa ti dilnin ato pamje makabre parasysh, duke kuptuar përfundimisht fatin tragjik që e priste bashkë-familjarin e tij, nga i cili nuk kishte më kthim prapa, as pritej shpëtim për të.

Por, ja që me ardhjen e komunistëve në pushtet, nuk njihte më fqinji - fqinjin, vëllai - vëllain as miku mikun, do të harrohej ideali për Shqipërinë Etnike dhe një Atdhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Ata edhe pse në shtetin e tyre të lirë dhe pjesëtar të të njëjtit komb, tanimë kishin filluar ta vrisnin me “ëndje” njëri tjetrin.

(Për më tepër, shih faksimilen, nga dorëshkrimi i Hysen Sali Qarrit)

Al Bunjese (Hapsone) Si të thashë Lijë Muntash-veva
 Dasha Ahmeti Gani. Ra e zun me zyretë e Bujarije.
 Dasha H. Gani e Gani e Bunjese Shkoder dhe Udhëz Alie

Selim Imer Qarri e Kuran e Shpigojta e Beka
 Imeri Imeri Qarri me duket e me se Sifirani e Prusë, (Dhoni)
 Imeri Qarri e Shpigojta Sali H. G. e dora gulligë, Edhe e
 Bekoni. FARE SALLINEN. Ahmeti. Imeri Imeri Qarri.
 O Cika e Hiper Sali. Kofi Deen lo pi një kofe e Hiper S. G.
 dhe Beni jo. E me Bajram kofe se kanë wakim jama
 Met Quiet. e se e Imeri me dardës bet e jet e Gani Mead
 FARE S. G. Imeri: Imeri Qarri. Shka Dora (G) ka E
 O Imeri Qarri. Jo kofe por me se dhe Dora (G) /
 Helem. Si k'e Fajet me Lupa kofe me një e
 Bobajemi, e Sali Gani. Qaba se eke Lili e me e koma
 Kufia, tona se Dora kofet koma qon një shpi Baskat
 Imeri Qarri H. G. me Cika e Sali H. G. e koma. e Bell me se
 me Bani. Imeri për koma kofe e Pashkaban me kofe
 e me e koma. Sali H. G. e kofe një kofe kofe për koma e
 Epiran. Bell e me me Beni. Imeri Sali. Imeri O. Imeri Sali.
 E dhe Abaz Mehmet Gani e Kuran e Heronjve Tepelenë
 Edhe Imeri Imeri Qarri gjithë me Bunjese kofe kofe me se
 NDARJE'S SAPI'S GARRIT se i cille. Imeri me Sali të vet

Kështu edhe Selim Qarri, do të pushkatohej, pa gjykim. Edhe ai, si shumë të tjerë, u ekzekutua pa shkas as arsyetim në Kukës të vjetër, aty ku ndër vite bashkohen Dy Drinët; Drini i Bardhë dhe Drini i Zi, vend të cilin në një kohë jo fort të largët Isa Buletinin e kishte kthyer në “istikam” për të luftuar ushtrinë serbe të gjeneralit famëkeq Bozhidar Jankoviq, por që shqiptarët tanimë e kishin shndërruar në arenë ekzekutimi për të shfryrë inatet dhe vrarë njëri tjetrin, veprim thuajse i ngjashëm, me atë të Kadri Mehmetit vite më parë, ndaj kushëririt të vet dhe mikut e dashamirit familjar të shtëpisë së Salih Qarrit, Heroit Bajram Curri.

Sikur, mos të mjaftonin të gjitha këto, pa vonuar, do të burgosej edhe Xhajë Imer Qarri, kurse Abaz Mehmet Qarri do të internohej në Tepelenë. Madje, pa kaluar shumë kohë, familjes së Sali Qarrit, do t’i merrej e gjithë pasuria, toka dhe bagëtia e numërt, duke i urdhëruar ata edhe të ndahen e krijojnë sa më shumë familje, me sa më pak anëtar.

I dëshpëruar, nga katrahurat e njëpasnjëshme edhe i zoti i kësaj shtëpie të madhe fisnike e bujare, nuk do të jetonte gjatë. Ai, vetëm 5-6 vite pas ardhjes së komunizmit në pushtet, i brengosur nga gjithë ato sa po ndodhnin në familjen e tij, do të vdiste i dëshpëruar më 1951, mezi duke arritur moshën 65-vjeçare.

Vetëm pas klasifikimit të luftëtarëve popullor dhe ngritjes së Bajram Currit në pedestalin e Heronjve Kombëtar, edhe Familja e Sali Qarrit, në një farë mënyre, sipas tregimeve të Hysenit, do të rehabilitohej. Madje, për mbajtjen dhe mbështetjen e Bajram Currit dhe

bashkëlufëtarëve të tij, ministria përkatëse e shtetit, do ta shpallte shtëpinë e Qarrit, “Familje të Nderuar”, kurse gruan e Salihut, Halë Qarrit “Nënë Patriote!”.

Ndaj nga atëherë e tutje, me këtë epitet, ajo do ftohej dhe nderohej në të gjitha tubimet dhe festat kombëtare e shtetërore, siç shprehet, pjesërisht, edhe autori i një reportazhi, nga vizita e E. Hoxhës, në Has, Kukës e Tropojë. (*“Kuvend ne Bjeshkët”, Pjesa I*).

Për ndihmesën e pa kursyer të Shtëpisë së Qarrit të Madh të Hasit, ndaj Bajram Currit, Azem Bejtës, Shote Galicës, Sadik Ramës e figurave tjera të shquara kombëtare, sipas Hysen Qarrit dhe pjesëtarëve tjerë të kësaj familje, në Kinostudion “**Shqipëria e Re**” të **RTSH**, ekziston edhe një kasetë, me një dokumentar të zhvilluar deri në detaje, nga Ndue Ukcama, i cili me një shkrim në fb, më dërgon këto shpjegime:

Sipas autorit, dokumentari në fjalë u zhvillua me rastin e 50 vjetorit të vrasjes së heroit dhe titullohet: “Bajram Curri në 50 vjetorin e rënjes së tij”

Ja faksimili i dërguar nga i nderuari, z. Ndue Ukcama:

04.07.2015 19:24

Ndue Ukcama

Pershendetje Gani! Dokumentari i kushtohet Bajram Currit ne 50 vjetorin e rënjes. Dhe midis deshmive te tjera eshte edhe intervista ne shtepine e Sali Qarrit, konkretisht biseda me Halë Qarrit(ne vitin 1975, kur u muar intervita ajo ishte rreth moshes 80 vjeçare). Sali Qarri dhe Familja e tij e Qarrit te Masdh te Hasit me mbi 30 meshkuj per pushke, e kishte mbajtur Bajram Currit sidomos ne bjeshke, gjate viteve 1922-1924. E tani kur Bace Bajrami u vra, ne rrugetimin per ne Krume, e sollen te shtepia e Sali Qarrit per ta provukuar. Konkretisht oficeret i thane Sali Qarrit: - O Sali Qarri, dil e jepi pak buke Bajram Currit, apo preja nje berr. - Keshtu si e keni ba ju Bajram Curri nuk ka nevojë per ushqim..et. etj. Pra dokumentari eshte i Radiotelevizionit shqiptar dhe titullohet " Bajram Curri" ne 50 vjetorin e rënjes se ti. Te pershendes!

“Epilog mbi jetën dhe veprën e Bajram Currit”

Gjatë gjithë përpjekjeve kombëtare e luftarake të Bajram Curri, nuk pati pëllëmbë toke në të gjitha trojet tona etnike, ku këmba e tij nuk shkeli. Pushka e heroit nuk la vend pa krisur anë e mbanë etnisë shqiptare, kudo që luftohej e veprimej për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Ai ishte dhe mbeti një personalitet me dinjitetit të lartë dhe të palëkundshëm të heroit, i cili ngado shkoi përjetësoi kujtime të pashlyera dhe u prit e përcoll me shumë dashamirësi të rrallë.

Bajram Curri nuk pati trashëgimtar, pas vetes la vetëm gruan dhe dy vajza, njëra nga të cilat jetoj në Tiranë kurse tjetra në Shkodër, ku sot gjenden mbesat e tij.

Por megjithatë, edhe dhembjen e shprehur për të në vajtime, si në vargjet vijuese;

Ajo pushkë beg që të mur ty

Mur Krasniqen shpi për shpi....

Heroi, sikur u mundua t`ua hiqte njerëzve vuajtjen për të, ngase ai kishte një brengë më të madhe se vetvetja, madje aq sa ishte krejt Atdheu, ndaj dhe shprehet me aq shpirtmadhësi duke na kujtuar edhe neve se atdheu është mbi të gjitha, sidomos kur thotë;

Unë për vete nuk po kam dert

Se i kam mbush 70 vjet

Por po më dhembet Kosova shkret

Që më, për të, kush një fjalë se flet!

Ai gjatë gjithë jetës, luftoi kundër turqve, serbo-malazezve, bullgarëve, italianëve e grekëve, si dhe kundër të gjithë tradhtarëve pa dallim, kudo që ata ngritën krye, kundër lirisë dhe tërësisë territoriale të vendit.

Personalitetin historik të Bajram Currit me njerëzit dhe trojet e këtij vendi, e lidhën përpjekjet e vendosura atdhetare, vuajtjet e përbashkëta dhe luftimet e gjata e të pareshtura kombëtare për çlirim dhe bashkim të shqiptarëve, të cilat ai i ngriti në filozofi gjithëkombëtare dhe unike për të gjithë shqiptarët.

Edhe, në këngët që këndohen për të, ka mjaft vargje dramatike të cilat dëshmojnë vendosmërinë e Bajram Currit, për të mos u dorëzuar as në momentet e fundit të jetës së tij, i cili thirrjes së mercenarit Kadri Mehmeti për dorëzim, do t'i përgjigjej po me atë vendosmëri dhe trimëri që kishte vepruar gjatë gjithë jetës:

Nuk më ka lidhë Krajli as Mbreti

Jo po më lidh, Kadri Mehmeti

Nxor Alltinë dhe i ka ra veti

Kështu shpjegohet fati tragjik i këtij heroi, ish ministër i luftës dhe komandant i përgjithshëm forcave të luftës, mbrojtës i tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe simbol i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, kudo jetojnë ata në trojet e tyre etnike.

Emri dhe vepra e tij heroike, ndriçuan fuqishëm ndërgjegjen patriotike të të gjithë atdhetarëve.

Edhe pse qeveritë shoviniste serbe disa herë i kishin ofruar poste, para dhe pasuri të shumta, vetëm e vetëm që ai të hiqte dorë nga veprimtaria e tij atdhetare, Bajram Curri nuk do t'i pranonte kurrë ofertat e tyre dhe të askujt tjetër në dëm të vendit dhe popullit që i takonte.

Sipas Prof, dr. Marenglen Verlit, ai vazhdimisht theksonte me bindje “Nuk pranoj të tradhtoj atdheun dhe të korit veten për të shpëtuar vetëm një shpirt”. Ndaj edhe nuk ndaloi kurrë së luftuari për idealin e përgjithshëm të bashkimit kombëtar, deri në vdekje.

Fan Noli pas vrasjes së heroit, do ta shprehte me dhembje të pa përshkruar konsideratën, për mikun dhe bashkëpunëtorin e tij më të afërt, duke ia kushtuar njëren nga elegjitë e tij më të mira, frymëzuara nga veprimtaria e ndritshme kombëtare e Bajram Currit, gjë që nuk ndodh shpesh në historinë e udhëheqësve shqiptarë.

E gjithë lufta dhe përpjekja e tij, patën për qëllim, çlirimin dhe ruajtjen e Shqipërisë Etnike, por fatkeqësisht ai u shua tradhtisht dhe para kohe nga vet shqiptarët, duke vdekur i dëshpëruar dhe me mallin e pashuar në zemër, për të parë Kosovën e lirë dhe bashkimin e saj me Shqipërinë, për të cilat luftoi pareshtur gjatë gjithë jetës së tij.

Është shumë domethënës edhe vetë titulli i elegjisë në të cilën Fan Noli, duke mos mundur të pajtohej me vdekjen e tij, shkruante:

Thonë u shtri e thonë u vra,

Po ti s'vdiqe, or Baba.

Bajram Curri, edhe pse në ato kohë të vështira e mbylli jetën e tij pa shumë shokë dhe bashkëluftëtarë, ai vdiq hero dhe me nder të pacenuar asnjëherë, duke mbetur i pathyeshëm si gjithmonë dhe pa lëshuar kurrë armën nga dora, deri në momentet më të fundit të jetës së tij.

Ishte janari i vitit 1925, dhe në malet e Dragobisë vetëm 7-8 luftëtarët e fundit atdhetar, kryesisht nga Krasniqja, Kosova dhe vise tjera të Veriut, i qëndronin ende pranë heroit, përkundër rrebeshit të dimrit dhe grackave të tradhtisë.

Shokët e tij ishin vrarë më herët, ndërsa tani i kishte ardhur radha atij, nga ata që nuk e priste.

Mjerisht, atë kohë, në Shqipëri dhe tokat shqiptare kudo, pas shuarjes së planifikuar dhe të njëpasnjëshme të heronjve më të shquar, tanimë pakë burra kishin mbetur, nga ata që ende ndienin përgjegjësi të vërtetë kombëtare dhe ruanin të pastër idealin atdhetar, për të ardhmen e përbashkët të të gjithë shqiptarëve.

Ndaj, shumë këngë dhembjeje e zhgënjimi pasqyrojnë qëndresën e vendosur të atyre pak kreshnikëve që ende shoqëronin shtegtarin e luftës dhe të lirisë, të cilët edhe ata po numëronin orët e fundit, pasi që Kadri Mehmeti u kërkonte me cinizëm dorëzimin edhe bijve të historisë, para se krye-heroi të zinte vend në këtë këngë!

Pra, se si dhe me çfarë ndjesie të rëndë shpirtërore do ta përjetonte populli shqiptar vrasjen e Bajram Currit, më së miri flasin këto vargje dëshpërimi:

Q ‘ajo pushkë Beg, që t’mori ty

Mur Krasniqen, shpi për shpi

Gash, Bytyç e deri në Dri

Krejt Kosovën, bit e vij

Ky burrë i pavdekshëm vërtetë pati një mision të vështirë, por të çartë e të ndershëm dhe patriotik. Për realizimin e tij, ai kaloi pothuajse tërë jetën maleve të atdheut, duke mishëruar idealet më fisnike të rilindësve tanë historik, ndaj mënyra tragjike e përfundimit të jetës së heroit, me të drejtë, sikur dridhi edhe themelet e Rilindjes së Kombit, nga trishtimi për mënyrën e shuarjes së pjesëtarit të fundit të sajë që kishe mbërri të mbijetonte deri atëherë!

Madje, megjithëse Bajram Curri, ishte i vetëdijshëm se përndjekjes së tij, nga ana e regjimit zogist, po i afrohej fundi tragjik, ai nuk mund të mos kujtonte me krenari të gjitha vuajtjet, mundimet dhe përpjekjet e pareshtura atdhetare, betejat dhe burrat e rënë të kombit, të cilët njëjtë si ai, edhe ata, patën larë me gjakun e vet, tokën e atdheut”.

Plaga që heroit pati në zemër, mbeti e hapur ,nga pamundësia e realizimit të lirisë së plotë dhe bashkimit të atdheut. Ajo u kthye në “plagë kombi,, dhembja e së cilës, për kohë të gjatë do ti mendojë shqiptarët kudo.

Me porosinë që pas vdekjes të varrosej në Has, ai donte tua bënte të ditur banorëve vendor se nuk kishte harruar asnjëherë mbështetjen dhe besnikërinë e tyre.

Madje, me gjithë epitetin e Heroit të nderuar , madhështinë dhe gjenialitetin që gëzonte, ai kurrë nuk kërkoi ti bëhej vend mes gjeneralësh emërmëdhenj, por vetëm ri-përsëriti amanetin, për një varrim të thjeshtë të trupit të tij në Has, vendin ku përherë u mirëprit bujarisht dhe gjithmonë ndjehej si në shtëpi të vet.

Amaneti i lënë për së gjalli, jo vetëm se shprehte në mënyrën më të mirë dhe me tërë fuqinë, falënderimin e përhershëm të heroit edhe pas vdekjes, për hasjanët, por forconte përjetshëm edhe dëshirën e madhe e të pafund të Bajram Currit, për të qëndruar përgjithmonë, sa më afër atdheut të shumëvuajtur të të parëve të tij dhe Kosovës martire, për lirinë e së cilës , ai luftoi dhe u përpoq pareshtur deri sa vdiq, pa lëshuar kurrë pushkën nga dora.

Megjithëse liria për të, mbeti vetëm një iluzion, historia vetë, duke njohur detyrën e ndritshme të heroit, të cilën ai gjithmonë e kreu me nder të veçantë dhe përkushtimin më të lartë, nga Dragobia ku Bajram Curri u vra, e mori në gji të vet dhe shndërroi në banorë të përhershëm të saj, duke e vendosur Plakun e Maleve plot krenari në piedestalin e emrave më të lavdishëm nëpër kohë, të cilët përherë rrezatojnë patriotizëm, nder dhe lavdi kombëtare.

Përmes amanetit të përsëritur disa herë, që trupi i tij, përfundimisht të varrosej në Has, Bajram Curri edhe pas vdekjes, nga amshimi dhe bota tjetër, sikur deshi tu shprehte hasjanëve në formën më bindëse dhe mënyrë të përjetshme, mirënjohjen e tij më të thellë, për besnikërinë, sakrificat, mikpritjen dhe krejt ndihmesën e pa-hile, që gjatë gjithë atyre viteve, me përjashtim të ndonjë bajraktari të shitur, ata i ofruan Heroit të tyre shpirtëror e kombëtar, pa asnjë kursim, fakt me të cilin kemi arsye të krenohemi pafundësisht të gjithë bijtë e kësaj treve bujare e mikpritëse të sinqert.

Por, ajo që ende nuk e kuptojnë as morën përgjigje hasjanët, atëherë e sot, është fakti i tërheqjes “zvarrë” të trupit të heroit, nga Hasi në “Bajram Curr”, pa asnjë sqarim apo shpjegim bindës. Pse?!

Ishte fjala vetëm për nderimin e atij qyteti me emrin e Heroit, larja e mëkateve ndaj tij, apo çfarë arsytimi tjetër pati, i cili nuk u tha asnjëherë, por që megjithatë, pa ndonjë konsultim të njohur deri më tani me vendorët as të drejtë morale apo edhe kanunore të kohës, u lëkundën eshtrat e Plakut të Maleve dhe prish qetësia e amshimit të përjetshëm të Bajram Currit edhe për së vdekuri, megjithëse ai vet, sa ishte gjallë, e pati lënë me gojë, që trupi i tij të përjetësohej përgjithmonë në Has.

Sido që të jetë, do të ishte mirë që historianët e njëmendët, përfundimisht ta thonë fjalën e tyre edhe për këtë të vërtetë ende të pa sqaruar, kurse ne përveç respektit dhe nderimit të pafund, deri në idealizimin e përhershëm të rënies së tij heroike, shpresojmë që edhe nëna Natyrë, dhe krijuesja e mbarë njerëzimit, ta ketë vendosur Heroin tonë, në pjesën më të zgjedhur të parajsës së saj, rezervuar për udhëheqësit më meritor, sublim dhe më të ndritshëm popullor, të cilët vetëm ndërrojnë jetë, por nuk vdesin kurrë!

Gani Qarri, Cyrih - korrik 2015

~~~~~  
© *Pashtriku.org, Korrik'2015*  
~~~~~